



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06/IA013

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatës Kai Ambos

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 maj 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet që Kundërshtojnë Ligjshmërinë e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe mbi Pretendimin për Shkelje të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

Përmbajtja e Lëndës

I. Historiku	1
II. Standardi i RISHIKIMIT	6
III. Çështje Paraprake.....	6
IV. DISKUTIM	7
A. gabimet e pretenduara në lidhje me mandatin kohor të dhomave të specializuara (pika e dytë e Thaçit)	7
1. Parashtrimet e Palëve.....	7
2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	9
B. Gabimet e pretenduara në lidhje me shkeljet e të drejtave kushtetuese	13
1. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar nëse korniza e të drejtës materiale të Dhomave të Specializuara shkakton pabarazi, në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, duke e bërë Gjykatën “të paligjshme” në kuptim të nenit 103(7) të Kushtetutës (pika e Veselit)	13
(a) Parashtrimet e palëve	13
(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	19
2. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh se, të marra së bashku, karakteristikat e Dhomave të Specializuara nuk plotësojnë në mënyrë strukturore kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së (pika e pestë e Thaçit)	26
(a) Parashtrimet e palëve	26
(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	26
3. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se periudha përkatëse për t’u gjykuar brenda një periudhe të arsyeshme filloi vetëm më 17 nëntor 2019 (pika e shtatë e Thaçit).....	29
(a) Parashtrimet e Palëve	29
(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	30
4. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se përfshirja e Raportit të Këshillit të Evropës ndërmjet “Dokumenteve Themeluese” të Dhomave të Specializuara nuk shkelti prezumimin e pafajësisë (pika e tetë e Thaçit).....	34
(a) Parashtrimet e Palëve	34
(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit	36
V. KËRKESA REFERUESE E VESELIT DREJTUAR DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË GJYKATËS KUSHTETUESE.....	40
VI. VENDIM.....	41

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim apelet e dorëzuara më 15 nëntor 2021 (“Apelet”) e Hashim Thaçit (“Thaçi”)² dhe Kadri Veselit (“Veseli”)³ (bashkërisht, “të akuzuarit”) kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe mbi Shkeljet e Pretenduara të disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve (“Vendimi i Kundërshtuar”).⁴ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS-ja”) iu përgjigj apeleve më 6 dhjetor 2021.⁵ Të akuzuarit u kundërpërgjigjën më 16 dhjetor 2021.⁶

I. HISTORIKU

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (“Aktakuza

¹ F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 26 tetor 2021.

² F00004, Apel i Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarit, 15 nëntor 2021 (“Apeli i Thaçit”).

³ F00005, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që kundërshtojnë Shkeljet e disa të drejtave kushtetuese të të Akuzuarit (F00450), 15 nëntor 2021 (“Apeli i Veselit”). Shih gjithashtu F00003, Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Ndryshim Afati, 1 nëntor 2021.

⁴ F00450, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 31 gusht 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

⁵ F00006, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Veselit kundër Mocioneve që kundërshtojnë shkeljet e të drejtave kushtetuese, 6 dhjetor 2021 (“Përgjigja ndaj Apelit të Veselit”); F00007, Përgjigja e Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450, 6 dhjetor 2021 (“Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit”) (kolektivisht, “Përgjigjet”).

⁶ F00010, Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450, 16 dhjetor 2021 (“Kundërpërgjigja e Thaçit”); F00011, Kundërpërgjigjja e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Kundërshtojnë Shkeljet e të Drejtave Kushtetuese, 16 dhjetor 2021 (“Kundërpërgjigja e Veselit”) (kolektivisht, “Kundërpërgjigjet”). Shih gjithashtu F00009, Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Ndryshim të Numrit të Lejuar të Fjalëve, 10 dhjetor 2021.

e Konfirmuar”).⁷ Më 30 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar.⁸ Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar (“Aktakuza”).⁹ Më 29 prill 2022, ZPS-ja parashtrroi Aktakuzën e ndryshuar.¹⁰

2. Më 5 nëntor 2020, në bazë të fletarrestimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹¹ të akuzuarit u arrestuan¹² dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.¹³

3. Më 12 mars 2021, Thaçi dorëzoi një mocion ku kërkon hedhjen poshtë të Aktakuzës për shkak të mungesës së juridiksionit¹⁴ dhe një mocion tjetër ku

⁷ F00026/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 26 tetor 2020).

⁸ F00034/A01, Aktakuzë, 30 tetor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*); F00045/A03, Aktakuzë e Redaktuar më Tej, 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 5 nëntor 2020).

⁹ F00455/RED/A01, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)', KSC-BC-2020-06/F00455, datë 3 shtator 2021, 8 shtator 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 shtator 2021; versioni konfidencial i redaktuar u dorëzua më 8 shtator 2021) (“Aktakuza”). Versioni konfidencial me më pak redaktime i aktakuzës së korrigjuar u dorëzua më 17 janar 2022. Shih F00647/A01, versioni konfidencial me më pak redaktime i Aktakuzës, KSC-BC-2020-06/F00455/A01, datë 3 shtator 2021, 17 janar 2022 (konfidencial).

¹⁰ Shih F00789, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve lidhur me të me Shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, shtojcat konfidenciale 2-4, dhe shtojcat publike 5-7, 29 prill 2022.

¹¹ F00027/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hashim Thaçin, 11 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 26 tetor 2020); F00027/A03/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Kadri Veselin, 5 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 26 tetor 2020). Shih gjithashtu F00027/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 26 tetor 2020).

¹² F00050, Njoftim i Arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 5 nëntor 2020); F00051, Njoftim i Arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 5 nëntor 2020).

¹³ F00053, Njoftim i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Caktimit të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 5 nëntor 2020); F00054, Njoftim i Pranimit të Kadri Veselit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe Caktimit të Mbrojtësit, 5 nëntor 2020, (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 5 nëntor 2020).

¹⁴ F00216, Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit, 12 March 2021.

kundërshton, ndër të tjera, ligjshmërinë e Dhomave të Specializuara dhe pretendon disa shkelje të të drejtave të tij.¹⁵

4. Më 15 mars 2021, Veseli dhe Selimi dorëzuan mocione duke kundërshtuar ndër të tjera ligjshmërinë e Dhomave të Specializuara dhe duke pretenduar disa shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese.¹⁶

5. Më 23 prill 2021, në pajtim me afatin e përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹⁷ ZPS-ja parashtroi dy përgjigje përmbledhëse të ndara ndaj këtyre mocioneve në lidhje me, ndër të tjera, ligjshmërinë e Dhomave të Specializuara dhe shkeljet e disa të drejtave të parashtruara nga Thaçi, Veseli dhe Selimi.¹⁸

6. Më 14 dhe 17 maj 2021, në pajtim me afatet përkatëse të përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹⁹ Thaçi,²⁰ Veseli²¹ dhe Selimi²² dorëzuan kundërpërgjigjet e tyre.

7. Më 31 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kundërshtuar, ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera: (i) hodhi poshtë

¹⁵ F00217, Mocioni që kundërshton juridiksionin mbi bazën e shkeljes së të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë, 12 mars 2021 (“Mocioni i Thaçit”).

¹⁶ F00224, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Kadri Veselit që Kundërshton Juridiksionin mbi bazën e Shkeljeve të Kushtetutës, 15 mars 2021 (“Mocioni i Veselit”); F00219, Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për shkak të Mungesës së Juridiksionit – Diskriminim, 15 mars 2021.

¹⁷ Transkript, 24 mars 2021, f. 391, rreshtat 11-19.

¹⁸ F00259, Përgjigja e Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës Afatin e Hetimit dhe Mandatin Kohor, 23 prill 2021; F00260, Përgjigja e Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe me Pretendimet për shkeljet e të drejtave, 23 prill 2021.

¹⁹ F00296, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Afatit, 14 maj 2021.

²⁰ F00304, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake të Raprotit të Këshillit të Evropës, Afatit Hetimor dhe Mandatin kohor”, 14 maj 2021; F00305, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake në lidhje me Statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Shkeljeve të Pretenduara të të Drejtave” 14 maj 2021.

²¹ F00308, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake që kundërshtojnë Juridiksionin mbi bazën e shkeljeve të Kushtetutës, 17 maj 2021.

²² F00307, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Selimit ndaj “Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocioneve Paraprake në lidhje me statusin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Pretendimet për Shkelje të Drejtash” 14 maj 2021.

kundërshtimet në lidhje me mandatin kohor të Dhomave të Specializuara; dhe (ii) nuk konstatoi shkelje të të drejtave kushtetuese të të akuzuarve dhe rrjedhimisht nuk gjeti asnjë bazë për anulimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara.²³

8. Më 17 shtator 2021, pasi u miratua shtyrja e afatit,²⁴ Thaçi dhe Veseli parashtruan kërkesa me të cilat kërkonin leje për apel në lidhje me pika që kanë të bëjnë me Vendimin e Kundërshtuar.²⁵

9. Më 6 tetor 2021, pasi u miratua shtyrja e afatit,²⁶ ZPS-ja parashtroi përgjigjet e saj ndaj kërkesës për leje për apel të Thaçit²⁷ dhe kërkesës për leje për apel të Veselit.²⁸

10. Më 18 tetor 2021, Thaçi dhe Veseli u kundërpërgjigjën.²⁹

11. Më 25 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apel ndaj Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljet e Pretenduara të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve” (“Vendimi për Leje për Apel”), duke autorizuar apelin

²³ Vendimi i Kundërshtuar, para 68, 88, 111, 115, 130, 142-143, 146.

²⁴ F00458, Vendim Përmbledhës mbi Kërkesat për Zgjatje Afati, 6 shtator 2021.

²⁵ F00473, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 17 shtator 2021 (“Kërkesa për Autorizim e Thaçit”); F00474, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime për Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Kushtetutës (KSC-BC-2020-06/F00450) (F00474 datë 17 shtator 2021), 18 tetor 2021 (“Kërkesa për Autorizim e Veselit”).

²⁶ F00490, endim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për t’iu Përgjigjur Kërkesave për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450, 24 shtator 2021.

²⁷ F00506, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Hashim Thaçit për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 6 tetor 2021.

²⁸ F00507, Përgjigje e Prokurorisë ndaj “Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime për Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Kushtetutës, 6 tetor 2021.

²⁹ F00532, Kundërpërgjigja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj “Përgjigjes së prokurorisë ndaj kërkesës së Hashim Thaçit për autorizimin për të apeluar ‘Vendimin mbi Mocionet që kundërshtojnë Ligjshmërinë e DHS-së dhe ZPS-së dhe pretendimin e shkeljeve të disa të drejtave kushtetuese të të akuzuarve”, 18 tetor 2021; F00530, Kundërpërgjigja e Veselit ndaj përgjigjes së ZPS-së për dorëzimin e KSC-BC-2020-06/F00474, 18 tetor 2021 (“Kundërpërgjigja e autorizimit të Veselit”).

e Veselit dhe pjesërisht apelin e Thaçit në lidhje me pikat e mëposhtme (“Pikat e Apeluara”):³⁰

- (a) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur erdhi në përfundim se për aspektin e mandatit kohor të DHSK-së ishte “marrë vendim nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK-ja”), pa dhënë arsyetim ose të paktën arsyetim të mjaftueshëm, dhe në kundërshtim me nenet 113(7) dhe 144(3) të Kushtetutës së Kosovës (“Kushtetuta”), të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i mori aspak parasysh (“pika e dytë e Thaçit”);
- (b) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur nuk mori parasysh faktin se, të marra së bashku, karakteristikat e Dhomave të Specializuara të ngritura nga Mbrojtja e Thaçit çojnë në përfundimin se nga ana strukturore Dhomat e Specializuara nuk plotësojnë kushtet e nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) (“pika e pestë e Thaçit”);
- (c) Sa i takon të drejtës për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se periudha përkatëse më 17 nëntor 2019, duke u mbështetur gabimisht në një interpretim kufizues të jurisprudencës relevante të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (“pika e shtatë e Thaçit”);
- (d) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se përfshirja e Raportit për Trajtimin Çnjerëzor të Personave dhe Trafikimin e Paligjshëm të Organeve Njerëzore në Kosovë, miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 7 janar 2011 (“Raporti i Këshillit të Evropës”) mes “Dokumenteve Themeluese” të Dhomave të Specializuara nuk shkeli parimin e prezumimit të pafajësisë së Thaçit (“pika e tetë e Thaçit”); dhe

³⁰ F00546, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apel ndaj “Vendimit mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve”, 25 tetor 2021 (“Vendimi i Leje për Apel”), para 21, 28, 33, 37, 42, 47, 53, 60, 66-68.

- (e) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur nuk shqyrtoi nëse korniza e së drejtës materiale të Dhomave të Specializuara shkakton pabarazi para ligjit në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, çka e bën Gjykatën “të paligjshme” në kuptim të nenit 103(7) (“pika e Veselit”).

II. STANDARDI I RISHIKIMIT

12. Paneli i Gjykatës së Apelit miraton standardet e rishikimit të përcaktuara në vendimin e tij të parë dhe të zbatuara në vijim.³¹

III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

13. Veseli kërkon që apeli të shqyrtohet së bashku me Apelin e Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara,³² para të njëjtit panel të Dhomës së Gjykatës së Apelit “duke patur parasysh lidhjen e ngushtë” ndërmjet çështjeve të kontestuara në të dy apelet.³³ ZPS-ja përgjigjet se Veseli nuk ka të drejtë ta bëjë një kërkesë të tillë duke qenë se Kryetarja e Dhomave të Specializuara ka vendosur për panele të ndara për shqyrtimin e dy apeleve dhe nuk ka bazë ligjore për një ndryshim të këtyre paneleve.³⁴

14. Trupi Gjykues rikujton vendimin e tij të marrë në lidhje me Apelin e Veselit mbi Juridiksionin,³⁵ i cili e bën të tejkalar kërkesën për t'i shqyrtuar të dy apelet së bashku para të njëjtit panel. Gjithsesi, Paneli vëren se çështjet e ngritura në dy apelet

³¹ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para 4-14. Shih gjithashtu p.sh. IA010/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, 27 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2021), para. 6.

³² Shih IA009/F00010, Apel i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021 (“APELI i Veselit për Juridiksionin”).

³³ Apeli i Veselit, para 6, 50.

³⁴ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para 42-43.

³⁵ IA009/F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, 23 dhjetor 2021 (“Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin”).

janë të ndryshme dhe si të tilla nuk i shkaktohet asnjë dëm Veselit nga gjykimi i ndarë i këtyre apeleve.³⁶

IV. DISKUTIM

A. GABIMET E PRETENDUARA NË LIDHJE ME MANDATIN KOHOR TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA (PIKA E DYTË E THAÇIT)

1. Parashtrimet e Palëve

15. Thaçi argumenton se përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se mandati kohor i Dhomave të Specializuara dhe i ZPS-së nuk përfundoi më 3 gusht 2020, mbështetet në një keqkuptim të procesit të kontrollit kushtetues në Kosovë.³⁷ Thaçi parashtron se neni 162(13) i Kushtetutës përcakton mandatin maksimal kohor të Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së në pesë vite pas miratimit të ndryshimit kushtetues nr. 24 dhe se pjesa përkatëse e aktgjykimit të DHSGJK-së mbi të cilën u mbështet Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të arritur në përfundimin se ai nuk kishte përfunduar ishte *obiter dictum*.³⁸ Sipas Thaçit, aktgjykimi i DHSGJK-së në kërkesën referuese ³⁹ ishte një formë kontrolli abstrakt e cila e pengon Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të marrë një vendim mbi dispozitat që janë tashmë në fuqi, dhe prandaj çdo diskutim mbi këto dispozita mund të jetë vetëm *obiter dictum*.⁴⁰ Thaçi argumenton se mosrespektimi i dallimit ndërmjet kontrollit abstrakt dhe atij konkret kushtetues jo vetëm do të shkelte Kushtetutën por edhe do të privonte palën të cilës i është shkelur e drejta nga kërkitimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave kushtetuese.⁴¹ Gjithashtu Thaçi parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh

³⁶ Shin Apelin e Veselit, para. 28 (ku Veseli parashtron se çështjet e dy apeleve ndonëse “të lidhura ngushtësisht” janë të ndryshme); Kundërpërgjigja e Veselit, para. 7.

³⁷ Apeli i Thaçit, para. 33. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para. 48.

³⁸ Apeli i Thaçit, para 34-37, 47. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para. 48.

³⁹ KSC-CC-2020-11, F00015, Aktgjykim mbi Referimin e Amendamenteve të Propozuara të Kushtetutës së Kosovës, 26 nëntor 2020 (“Aktgjykimi i DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese”).

⁴⁰ Apeli i Thaçit, para. 38-48. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para 18-24.

⁴¹ Apeli i Thaçit, para. 46. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 17.

faktin se në aktgjykimin e DHSGJK-së, në kërkesën referuese, DHSGJK-ja nuk iu referua diskutimit të saj mbi mandatin kohor të Dhomave të Specializuara në konstatimin e saj mbi kushtetutshmërinë e ndryshimeve të propozuara kushtetuese numër 26 dhe 27.⁴²

16. ZPS-ja parashtron fillimisht se ekziston një shkëputje mes kësaj pike të apelit në kushtet e saj, të cilat kanë lidhje me çështjen e ngushtë nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabimisht u mbështet në aktgjykimin e DHSGJK-së mbi kërkesën referuese dhe masën ndreqëse që kërkon Thaçi dhe që ka lidhje me çështjen më të gjerë të faktit nëse ka mbaruar mandati kohor i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, për të cilën Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi kërkesën për leje për apel.⁴³ Për më tej, ZPS-ja parashtron se DHSGJK-ja ka deklaruar shprehimisht se, në përputhje me nenin 162(14) të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 04/L-274 mbi Ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë më 23 prill 2014 (“Shkëmbimi i Letrave”), mandati kohor i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së nuk është i kufizuar në pesë vite dhe një interpretim i ndryshëm do të ishte joetik në kuptimin e ndryshimit kushtetues nr. 24.⁴⁴ ZPS-ja gjithashtu argumenton se pjesa e rëndësishme e aktgjykimit të DHSGJK-së në kërkesën referuese nuk ishte *obiter dictum*, por “qendror” për qëndrimin e DHSGJK-së⁴⁵ dhe Thaçi nuk jep as “një citim të vetëm” për të mbështetur pretendimet e tij në lidhje me rezultatin e modelit të rishikimit kushtetues.⁴⁶ Së fundmi, ZPS-ja parashtron se pretendimet e Thaçit janë “të shkëputura si nga logjika ashtu edhe nga jurisprudenca”, duke qenë se së pari nuk ka tension në konstatimin e një ndryshimi kushtetues si lejues dhe në të njëjtën kohë konstatimin se rrethana të veçanta faktike të ngritura nga një individ e shkelin këtë

⁴² Apeli i Thaçit, para. 48. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para. 37; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 18.

⁴³ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 17-18.

⁴⁴ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 16, 19-26, 36.

⁴⁵ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 27-29.

⁴⁶ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para. 30.

dispozitë, dhe, së dyti, Gjykata Kushtetuese e Kosovës do të vlerësojë jo vetëm dispozitat kushtetuese dhe ligjore që janë tashmë në fuqi por herë pas here edhe “formulimin dhe frymën e rendit kushtetues”.⁴⁷

17. Thaçi kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk arrin të shpjegojë se përse ishte e nevojshme që të përfshihej kufizimi pesëvjeçar i mandatit të Dhomave të Specializuara nëse qëllimi legjislativ ishte që ato të krijoheshin për një periudhë të pacaktuar kohe dhe se neni 162(14) i Kushtetutës rregullon mandatin minimal kohor duke bashkeqzistuar pa konflikt me nenin 162(13) të Kushtetutës i cili rregullon mandatin maksimal.⁴⁸ Sipas Thaçit, argumenti i ZPS-së se mandati fillestar do të shtyhej automatikisht në mungesë të njoftimit sipas nenit 162(14) të Kushtetutës nuk gjen mbështetje as në tekstin e nenit 162(13) dhe as të nenit 162(14) dhe mund të arrihet vetëm nëpërmjet “një akti të paprecedent të aktivizmit gjyqësor”.⁴⁹

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

18. Fillimisht Paneli vëren se disa argumente të ngritura nga Thaçi në këtë pikë të apelit u ngritën si pjesë e pikës së propozuar për leje për apel që u hodh poshtë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake pasi nuk përmbushte kriteret e rregullës 77(2) të Rregullores.⁵⁰ Paneli rikujton se fushëveprimi i rishikimit shtrihet ngushtësisht brenda

⁴⁷ Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit, para 31-35.

⁴⁸ Kundërpërgjigja e Thaçit, para 25-26.

⁴⁹ Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 27.

⁵⁰ Vendimi për Leje për Apel, para. 20-21. Krahaso Vendimin për Leje për Apel, para 6(1), 17-19, referuar kërkesës për apel të Thaçit, para 10, 14 (që përcakton se një prej pikave për të cilat Thaçi kërkoi leje për apel ishte Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi ose nuk dha arsye të mjaftueshme, ndër të tjera, në lidhje me: (i) synimin legjislativ të Kuvendit; (ii) amendamentin nr. 26 të propozuar të Kushtetutës; dhe (iii) njoftimin sipas nenit 162(14) që është i zbatueshëm për mandatin kohor minimal me apelin, para. 35; Kundërpërgjigja e Thaçit, para 25-27 (duke parashtruar se: (i) ZPS-ja nuk arrin të shpjegojë se përse ishte e nevojshme të përfshihej afati pesëvjeçar i mandatit të Dhomave të Specializuara nëse qëllimi legjislativ ishte që ato të krijoheshin për një periudhë të pakufizuar; (ii) Neni 162(14) i Kushtetutës rregullon mandatin minimal kohor; dhe (iii) argumenti i ZPS-së se mandati fillestar do të shtrihet automatikisht në mungesë të njoftimit në përputhje me nenin 162(14) të Kushtetutës nuk gëzon mbështetje as në tekstin e nenit 162(13) dhe as të nenit 162(14)).

kufijve të pikave të autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake⁵¹ dhe prandaj, refuzon t'i shqyrtojë këta argumente. Sidoqoftë Paneli konsideron se në ndryshim nga argumenti i ZPS-së,⁵² lirimi i kërkuar i Thaçit është brenda fushës së pikës për të cilën është autorizuar apeli. Paneli vëren se masa ndreqëse që kërkon Thaçi në bazë të kësaj pike të apelit është që Vendimi i Kundërshtuar të shpallet i pavlefshëm dhe si i tillë, nëse Paneli do të miratonte këtë arsye për apel, pasoja në praktikë do të ishte e njëjtë si ajo e kërkuar në lidhje me çështjen për të cilën u refuzua leja për apel, konkretisht konstatimi se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së ka përfunduar.⁵³

19. Në lidhje me themelësinë e argumenteve të Thaçit, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kundërshtimet e Thaçit në lidhje me mandatin kohor të Dhomave të Specializuara në bazë të faktit se vlerësimi i DHSGJK-së për mandatin kohor të Dhomave të Specializuara nuk mund të konsiderohet si *obiter dictum*, por si një hap themelor në vendimmarrje, duke qenë se ndryshimet në paragrafët 13 dhe 14 të nenit 162 të Kushtetutës të propozuar nga ish-Presidenti Thaçi bazoheshin në një dykuptimësi në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara.⁵⁴

20. Paneli konsideron se teksti i aktgjykimit të DHSGJK-së në kërkesën referuese nuk mbështet argumentin e Thaçit se konstatimi mbi mandatin kohor të Dhomave të Specializuara ishte *obiter dictum*. DHSGJK-ja vendosi se:

Në nenin 162(13) dhe (14) përcaktohet se, në rast se nuk ka njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të

⁵¹ KSC-BC-2020-07, IA004/F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021 ("Vendimi mbi Mocionet Paraprake"), para. 20; KSC-BC-2020-07, IA005/F00008/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet Kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit, 29 korrik 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 korrik 2021) ("Vendimi mbi Nxjerrjen e Materialit"), para. 17.

⁵² Shih Përgjigjen ndaj Apelit të Thaçit, para. 17.

⁵³ Krahaso Apelin e Thaçit, para 48, 49(b) me Kërkesën e Thaçit për Leje për Apel, para. 14. Shih Vendimin për Leje për Apel, para 17-21.

⁵⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 65-68.

periudhës fillestare pesëvjeçare, mandati vazhdon pas periudhës fillestare pesëvjeçare deri kur Këshilli të njoftojë Kosovën për përfundimin e mandatit. Nuk ka pasur asnjë njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të periudhës pesëvjeçare fillestare në bazë të nenit 162(13). Rrjedhimisht, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i ZPS-së ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri në njoftimin prej Këshillit për përfundimin e mandatit sipas nenit 162(14).⁵⁵

21. Paneli vëren se këto konstatime janë në seksionin e aktgjykimit që diskuton specifikisht “Ndryshimet e Propozuara Kushtetuese” në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit. Paneli gjithashtu vëren se pasi ka analizuar mandatin kohor, DHSGJK-ja erdhi në përfundim se “prandaj, fshirja e përmendjes së Shkëmbimit të Letrave nga neni 162(13) dhe (14) i Kushtetutës] – siç propozohet në ndryshimet nr. 26 dhe nr. 27 - do të cenonin të drejtat dhe liritë e personave të përfshirë në proces”.⁵⁶ Paneli rikujton se *obiter dictum* përkufizohet si një vëzhgim apo vërejtje e bërë nga një gjykatës që nuk është domosdoshmërisht i përfshirë në çështje ose thelbësor për vendimmarrjen e saj.⁵⁷ Paneli vëren se nga ana tjetër pasoja logjike e arsytimit të gjykatësit tregon se konstatimet mbi mandatin kohor të Dhomave të Specializuara kanë lidhje të drejtpërdrejta dhe mbështesin përfundimin mbi mospërputhshmërinë e ndryshimeve të propozuara kushtetuese me të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese.

⁵⁵ Aktgjykimi i DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, para. 66. DHSGJK-ja gjithashtu konfirmoi se vazhdimi i mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së është në pajtim me Shkëmbimin e Letrave, që përmendet në nenin 162(13) dhe (14) të Kushtetutës, dhe parasheh se Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja “do të vazhdojnë deri sa Kosova të njoftohet nga Këshilli i Bashkimit Evropian [...] se çdo proces [...] ka përfunduar”. Shih Aktgjykimin e DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, para. 67. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 65.

⁵⁶ Shih Aktgjykimin e DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, para. 69.

⁵⁷ “Çfarë është Dictum” *The Law Dictionary* <<https://thelawdictionary.org/dictum/>> hapur më 19 maj 2022.

22. Në lidhje me pretendimin e Thaçit se DHSGJK-ja nuk citon mandatin kohor si të rëndësishëm për konstatimin e saj se ndryshimet e propozuara nuk përputhen,⁵⁸ Paneli vëren se këto pretendime shtrembërojnë Aktgjykimin e DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese. Në veçanti pjesa që përmend Thaçi ka të bëjë me një tjetër konstatim mospërputhshmërie dhe jo atë për të cilin është relevant mandati kohor, konkretisht nëse u bënë këshillime me autoritetet përkatëse të Bashkimit Evropian në lidhje me ndryshimet kushtetuese të propozuara. Për më tepër, DHSGJK-ja në përfundimin e saj të përgjithshëm gjykoi se “në bazë të nenit 116(1) të Kushtetutës, *ky aktgjykim* është detyruar për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës”.⁵⁹ Lëshimi i aktgjyimit natyrisht përqendrohet në përfundimin e gjykatës në lidhje me çështjen e kërkesës referuese pa përsëritur konsideratat që çuan në këtë përfundim. Kjo nuk do të thotë se këto konsiderata nuk kishin rëndësi ose që ato ishin *obiter dicta*. Vlerësimi me autoritet i dispozitave ekzistuese është në përputhje me fushëveprimin e vlerësimit sipas nenit 113(9) të Kushtetutës që është kryer më parë nga Gjykata Kushtetuese.⁶⁰ Paneli vëren në këtë aspekt se në Aktgjykimin e DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, vlerësimi i dispozitave ekzistuese kishte rëndësi të veçantë, pasi ndryshimet e propozuara kushtetuese do t’i kishin zëvendësuar ato. Argumenti i Thaçit mbi një ndarje të rreptë të dy llojeve të kontrollit kushtetues⁶¹ është

⁵⁸ Shih Apelin e Thaçit, para. 48, referuar Aktgjykimin të DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, para 71-75.

⁵⁹ Aktgjykimi i DHSGJK-së mbi Kërkesën Referuese, para. 78-79 (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para 19, 67.

⁶⁰ Shih p.sh. Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156*, KO 162/18, Aktgjykim, 7 shkurt 2019, paras 35-36 (ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës si pjesë e “Vlerësimit të kushtetutshmërisë së ndryshimit të propozuar [të nenit 22 të Kushtetutës]”, konfirmon se “përveç të drejtave që parashihen shprehimisht në Kapitullin II, Gjykata duhet edhe të vlerësojë përputhshmërinë e ndryshimit të propozuar me nenin 22”); Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar pesëdhjetë e pesë Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179*, KO 13/15, Aktgjykim, 16 mars 2015, para 34-35 (ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës në “Vlerësimin e ndryshimit të propozuar [të nenit 96 të Kushtetutës]” vërejtë se është e nevojshme që të konsiderojë ndryshimin e propozuar në kontekstin e të drejtave të komuniteteve të garantuara me Kushtetutë, përfshirë fushëveprimin e zbatimit të nenit aktual 96 të Kushtetutës).

⁶¹ Apeli i Thaçit, para 38-46; Kundërpërgjigja e Thaçit, para 17-18, 23-24.

rrjedhimisht i pabazuar, por edhe i ngritur për herë të parë në apel dhe si i tillë nuk do të shqyrtohet më tej.⁶²

23. Duke pasur parasysh sa më sipër, Paneli konstaton se Thaçi nuk ka arritur të vërtetojë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se çështja e mandatit kohor të Dhomave të Specializuara është gjykuar nga DHSGJK-ja. Paneli i Gjykatës së Apelit rrjedhimisht rrëzon pikën e dytë të Thaçit.

B. GABIMET E PRETENDUARA NË LIDHJE ME SHKELJET E TË DREJTAVE KUSHTETUESE

1. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar nëse korniza e të drejtës materiale të Dhomave të Specializuara shkakton pabarazi, në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, duke e bërë Gjykatën “të paligjshme” në kuptim të nenit 103(7) të Kushtetutës (pika e Veselit)

(a) Parashtrimet e palëve

24. Në pikën e parë të apelit, Veseli argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur përcaktoi se Dhomat e Specializuara u themeluan me ligj duke mos vlerësuar cilësinë e ligjit mbi bazën e të cilit ato u themeluan dhe specifikisht nëse Ligji ofron garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit.⁶³ Sipas Veselit, jurisprudenca e GJEDNJ-së thekson disa kritere cilësore për “ligjin”, duke nënkuptuar “se duhet të ketë një masë mbrojtëse në ligjin vendas kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike në të drejtat e mbrojtura”.⁶⁴ Veseli argumenton se Ligji nuk ofron garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit për tri arsye:⁶⁵ (i) zbatimi i të drejtës zakonore ndërkombëtare (“DZN-së”) nëpërmjet nenit 12 të Ligjit, ndërkohë që gjykatat e

⁶² Vendimi mbi Mocionet paraprake, para. 15.

⁶³ Apeli i Veselit, para 15, 17-18.

⁶⁴ Apeli i Veselit, para 16-17. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Veselit, para 10-11(a)-(c).

⁶⁵ Apeli i Veselit, para. 18.

zakonshme të Kosovës zbatojnë Kodin Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë ("RSFJ"), është në kundërshtim me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;⁶⁶ (ii) nuk ka një sistem objektiv nëse një person duhet të gjykohet në Dhomat e Specializuara sipas DZN-së ose brenda vendit sipas ligjeve vendore;⁶⁷ dhe (iii) nuk ekziston rishikimi gjyqësor për të kundërshtuar vendimin e ZPS-së për të gjykuar një person në Dhomat e Specializuara që është një shembull arbitrariteti për të cilin Ligji nuk ofron garanci, duke rezultuar në shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së si dhe të të drejtës për barazi dhe mosdiskriminim të mbrojtura nga Kushtetuta dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁶⁸ Veseli argumenton se, për sa kohë që Dhomat e Specializuara zbatojnë një kuadër të së drejtës materiale të ndryshëm nga ligji i Kosovës, ato operojnë si një gjykatë e jashtëzakonshme në kundërshtim me nenin 103(7) të Kushtetutës.⁶⁹

25. Në pikën e dytë të apelit, Veseli argumenton se ndryshimi kushtetues nr. 24, i cili ishte objekti i çështjes nr. KO26/15 para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, paraprin Ligjin dhe për këtë arsye Gjykata Kushtetuese e Kosovës në këtë çështje nuk parashihte se Dhomat e Specializuara do të zbatonin një tjetër kuadër të të drejtës materiale të ndryshëm nga ai i gjykatave të zakonshme në Kosovë.⁷⁰ Sipas Veselit, ky tipar ka "rëndësi të lartë" për vlerësimin nëse Dhomat e Specializuara janë një gjykatë e specializuar apo një gjykatë e jashtëzakonshme.⁷¹ Veseli parashtron se duke pasur parasysh këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur i dha peshe të tillë kësaj

⁶⁶ Apeli i Veselit, para. 19-20.

⁶⁷ Apeli i Veselit, para 21-22; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 11 (c)-(d). Veseli gjithashtu parashtron se: (i) ndonëse në lexim të thjeshtë të Ligjit vetëm personat e dyshuar për krime nga Raporti i Këshillit të Evropës mund të gjykohej, në praktikë asnjë prej pretendimeve të Raportit të Këshillit të Evropës nuk po ndiqet penalisht në Dhomat e Specializuara; dhe (ii) edhe nëse Raporti i Këshillit të Evropës u konsiderua një kriter objektiv, nuk ka justifikim për trajtimin e krimeve në aktakuzë brenda fushës së tij ndryshe nga të akuzuarit për të njëjtën sjellje dhe prandaj një kriter i tillë do të shkelte parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Shih Apelin e Veselit, para 22-23.

⁶⁸ Apeli i Veselit, para 24-26; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 11(d)-(e).

⁶⁹ Apeli i Veselit, para 27-28.

⁷⁰ Apeli i Veselit, para. 30-31. Shih gjithashtu Apelin e Veselit, para 32-33; Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 13.

⁷¹ Apeli i Veselit, para 31, 34.

çështje kur përcaktoi se Dhomat e Specializuara janë në përputhje me nenin 103(7) të Kushtetutës.⁷²

26. Në pikën e tij të tretë të apelit, Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) shkeli detyrimin e tij për të garantuar drejtësinë kur nuk trajtoi parashtrimet e Veselit në lidhje me *indicia* e përcaktuara nga Komisioni i Venecias në lidhje me përkufizimin e gjykatave të specializuara ose të jashtëzakonshme, një prej të cilave është “[n]ëse gjykata është e pajisur me kompetenca të veçanta ose nëse ndjek procedura të veçanta nga ato të zbatuara në gjykatat penale ekzistuese”; dhe (ii) ka bërë gabim ligjor duke mos i dhënë peshën e duhur këtij *indicium*.⁷³ Sipas Veselit, Dhomat e Specializuara manifestojnë karakteristika të një gjykate të jashtëzakonshme që janë të ndaluara nga neni 103(7) i Kushtetutës si dhe nga institucione të tjera vendore dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁷⁴

27. ZPS-ja parashtron se qasja e Veselit për të paraqitur tri pika të veçanta ndërkohë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi lejen vetëm për një të tillë tenton të anashkalojë kërkesat për leje për apel sipas rregullës 170 të Rregullores.⁷⁵ ZPS-ja argumenton se nëse Paneli nuk është i prirë që të hedhë poshtë pa e shqyrtuar të gjithë Apelin e Veselit, së paku nuk duhet të shqyrtohet asnjë parashtrim që del jashtë fushës së pikës së autorizuar për apel.⁷⁶ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se pika e parë dhe e tretë e apelit tejkalojnë fushëveprimin e Vendimit për Leje për Apel, përfshirë duke rihapur një kundërshti të përgjithshme të përputhshmërisë së Dhomave të Specializuara me nenin 103(7) të Kushtetutës, që është e shkëputur nga çështja e barazisë.⁷⁷ Për më tepër, ZPS-ja argumenton se ashtu si Apeli i Veselit mbi

⁷² Apeli i Veselit, para 34-35.

⁷³ Apeli i Veselit, para 37, 41-42, 46.

⁷⁴ Apeli i Veselit, para 36, 38-40, 43-45. Shih gjithashtu Apelin e Veselit, para 47-49; Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 16.

⁷⁵ Përgjigja ndaj Apelit të Veselit, para 11-12.

⁷⁶ Përgjigja ndaj Apelit të Veselit, para. 13.

⁷⁷ Përgjigja ndaj Apelit të Veselit, para 23, 35-36. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit të Veselit, para. 24.

Juridiksionin, Apeli i Veselit ka si premisë pozicionin se zbatimi i DZN-së i bën Dhomat e Specializuara antikushtetuese dhe se Apeli duhet të rrëzohet duke qenë se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara është plotësisht në përputhje me Kushtetutën.⁷⁸

28. Në lidhje me themelësinë e parashtrimeve të Veselit, ZPS-ja përgjigjet se Veseli nuk citon materiale të rëndësishme për arbitraritetin si faktor në vlerësimin nëse një gjykatë është “e bazuar në ligj” në kuptimin e nenit 103(7) të Kushtetutës⁷⁹ ose për lidhjen e zbatueshmërisë së DZN-së me parimin e barazisë para ligjit.⁸⁰ ZPS-ja gjithashtu argumenton se Veseli keqinterpretonte Vendimin e Kundërshtuar, duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoi: (i) aspektin e prapaveprueshmërisë dhe të parashikueshmërisë që burojnë nga zbatimi i DZN-së, të cilat kanë rëndësi për aspektet cilësore të kërkesës së “themeluar me ligj” si dhe pavarësinë dhe paanshmërinë që mundësohet nga Ligji;⁸¹ dhe (ii) “kompetencat e veçanta” të Dhomave të Specializuara.⁸²

29. ZPS-ja gjithashtu parashtron, në lidhje me pikën e parë të Apelit të Veselit në veçanti, se argumenti i Veselit në lidhje me pabarazinë nuk vërteton arbitraritetin dhe nuk është cituar asnjë burim për të ilustruar këtë argument dhe disa prej çështjeve që ai ngre janë tipare të përbashkëta të disa sistemeve ligjore.⁸³ ZPS-ja vë në dukje se fakti që një gjykatë nuk ka juridiksion mbi disa vepra penale nuk do të thotë që nuk është kryer krimi ose që një gjykatë tjetër ndalohet ta gjykojë këtë sjellje.⁸⁴ Gjithashtu ZPS-ja parashtron se përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Ligji kishte cilësi të mjaftueshme për të garantuar të drejtat e njeriut të të akuzuarit kur përcaktoi se

⁷⁸ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para 14-22. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit të Veselit, para 38-40.

⁷⁹ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 24.

⁸⁰ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 35.

⁸¹ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 25.

⁸² Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para 35, 37.

⁸³ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 26.

⁸⁴ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 26. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit të Veselit, para. 27.

Dhomat e Specializuara janë Gjykatë e Specializuar ishte i arsyeshëm.⁸⁵ Sipas ZPS-së, juridiksioni nuk mbështetet në baza diskriminuese dhe përzgjedhja e çështjes nga ZPS-ja dhe ngritja e akuzave u nënshtrohen kufizimeve të vendosura nga Ligji dhe Rregullorja, si dhe rishikimit gjyqësor.⁸⁶

30. Në lidhje me pikën e dytë të apelit, ZPS-ja përgjigjet se ajo përfshin pretendimet e abuzimit të diskrecionit dhe jo gabim juridik siç e përkufizon Veseli, gjë që është domethënëse duke qenë se vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për t'i dhënë peshë një konsiderate të veçantë meriton të respektohet.⁸⁷ Sipas ZPS-së, ishte e përshtatshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mbështetej mbi vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për kushtetutshmërinë e Dhomave të Specializuara, pasi ky aktgjykim u konsiderua ndërmjet shumë faktorëve të tjerë.⁸⁸ Gjithashtu ZPS-ja parashtron se ishte “qartësisht e parashikuar” nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës se Dhomat e Specializuara do të operonin në përputhje me një ligj të veçantë, siç parashihet në Shkëmbimin e Letrave.⁸⁹

31. Në lidhje me pikën e tretë të apelit, ZPS-ja argumenton se *indicium* të cilit i referohet Komisioni i Venecias nuk mund të jetë përcaktues nëse gjykata është e specializuar apo e jashtëzakonshme duke qenë se do të ishte në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës për vlerësimin e përputhshmërisë me nenin 103(7) të Kushtetutës.⁹⁰ ZPS-ja më tej parashtron se Veseli pranon se gjykatat e specializuara mund të ekzistojnë nëse plotësojnë garancitë e

⁸⁵ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 29. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit të Veselit, para. 40 (duke parashtruar se mbështetja në deklaratë të disa palëve ndërkombëtare të përfshira është e paefektshme).

⁸⁶ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, paras 27-28.

⁸⁷ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 30.

⁸⁸ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 31.

⁸⁹ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para 32-33. Shih gjithashtu Përgjigjen ndaj Apelit të Veselit, para. 34.

⁹⁰ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 38-39.

ofruara në gjykatat e zakonshme, të cilat, sipas ZPS-së, Dhomat e Specializuara i plotësojnë.⁹¹

32. Veseli kundërpërgjigjet se asnjë prej pikave nuk shkojnë përtej pikës së autorizuar për apel, pasi ato janë së paku të lidhura në mënyrë të pandashme me të.⁹² Veseli më tej përgjigjet se pika e parë “është plotësisht” brenda fushëveprimit të pikës së autorizuar për apel, duke qenë se cilësia e kuadrit të së drejtës materiale duhet marrë domosdoshmërisht në konsideratë nëse Dhomat e Specializuara janë të “ligjshme” në kuptim të nenit 103(7) të Kushtetutës.⁹³ Gjithashtu, Veseli parashtron se pikat në Apelin e Veselit për Juridiksionin dhe Apelin aktual nuk janë materialisht të njëjta, duke qenë se Apeli i Veselit për Juridiksionin ka të bëjnë kryesisht me aspekte të diskriminimit dhe pabarazisë para ligjit përkundrejt personave në shtete të tjerë pasardhëse të RSFJ-së, kurse apeli aktual përqendrohet në dallimin ndërmjet kuadrit të së drejtës materiale të Dhomave të Specializuara dhe regjimit të zbatuar nga gjykatat e zakonshme në Kosovë.⁹⁴

33. Në lidhje me themelësinë, Veseli konfirmon në kundërpërgjigjen e tij se pretendimet e tij në pikën e dytë të Apelit kanë të bëjnë më shumë me një gabim ligjor se sa abuzim me diskrecionin.⁹⁵ Gjithashtu, Veseli parashtron në lidhje me pikën e tretë të apelit se burimet mbështetëse janë përcaktuar qartësisht⁹⁶ dhe se “kompetencat e veçanta” që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i ka marrë në konsideratë në vlerësimin e tij të ligjshmërisë së Dhomave të Specializuara është aftësia e tyre për të zbatuar kuadrin e tyre të së drejtës materiale.⁹⁷

⁹¹ Përgjigjja ndaj Apelit të Veselit, para. 39.

⁹² Kundërpërgjigjja e Veselit, para 3-5.

⁹³ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 9. Veseli gjithashtu nuk bie dakord me pretendimin e ZPS-së se pika është propozuar për autorizim për apel nga Thaçi dhe është refuzuar.

⁹⁴ Kundërpërgjigjja e Veselit, para 5-8.

⁹⁵ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 12.

⁹⁶ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 15.

⁹⁷ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 17.

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

34. Fillimisht Paneli rikujton se fushëveprimi i i rishikimit të tij shtrihet ngushtësisht brenda kufijve të çështjeve të autorizuara për apel nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe, prandaj, Paneli mund të refuzojë të shqyrtojë argumentet e apeluesit që shkojnë përtej pikës në lidhje me të cilën është autorizuar apeli.⁹⁸Ndërkohë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi apelin vetëm për një pikë,⁹⁹ Veseli parashtron tre pika të apelit. Megjithatë, Paneli mund të shqyrtojë argumentet edhe nëse ato janë jashtë fushëveprimit të apelit për sa kohë që ato janë lidhur në mënyrë të pandashme me pikën e autorizuar për apel.¹⁰⁰ Në këtë aspekt, Paneli vëren se Veseli ka argumentuar shprehimisht në kërkesën për autorizimin për apel të pikës së dytë të apelit, konkretisht pretendimin e tij se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabimisht u mbështet në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës,¹⁰¹

⁹⁸ Vendimi mbi Mocionet Paraprake, para. 20; Vendimi për Nxjerrjen e Materialit, para. 17.

⁹⁹ Shih Vendimin për Leje për Apel, para 7, 66-68: “nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar nëse regjimi i të drejtës materiale të Gjykatës i jep shkak pabarazisë para ligjit në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, duke e bërë gjykatën ‘të paligjshme’ në kuptimin e nenit 103(7)”.

¹⁰⁰ Cf. ICTY, *Prosecutor v. Šešelj*, IT-03-67-AR73.4, Decision on Appeal against the Trial Chamber's Decision (No.2) on Assignment of Counsel, 8 December 2006, para. 20; ICC, *Situation on Registered Vessels of the Union of the Comoros, the Hellenic Republic and the Kingdom of Cambodia*, ICC-01/13-98, Judgment on the appeal of the Prosecutor against Pre-Trial Chamber I's 'Decision on the "Application for Judicial Review by the Government of the Union of the Comoros', 2 September 2019, paras 53-56; ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1817-Red, Public redacted version of the Judgment on Mr Bosco Ntaganda's appeal against the decision reviewing restrictions on contacts of 7 September 2016, 8 March 2017, paras 85-86; ICC, *Prosecutor v. Gbagbo and Blé Goudé*, ICC-02/11-01/15-744, Judgment on the appeals of Mr Laurent Gbagbo and Mr Charles Blé Goudé against the decision of Trial Chamber I of 9 June 2016 entitled “Decision on the Prosecutor's application to introduce prior recorded testimony under Rules 68(2)(b) and 68(3)”, 1 November 2016, paras 13-19. Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-09-69-AR73.2, Decision on Defence Appeal of the Decision on Future Course of the Proceedings, 16 maj 2008, paras 7-10 (wherein an appeals chamber of the International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (“ICTY”) decided to consider the arguments that “directly related” to the certified issue); ICTY, *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-AR73.2, Decision on Interlocutory Appeal Concerning Rule 92bis(C), 7 June 2002, para. 7 (wherein an ICTY appeals chamber held that it is within its discretion to determine “other, related, issues, ëhere it considers it appropriate to do so”).

¹⁰¹ Shih kërkesën për autorizim për apel të Veselit, paras 6-7; Kundërpërgjigjja e Veselit ndaj vendimit për autorizim për apel, para 3, 5, referuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar me 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me letrën Nr. 05-433/DO-318*, KO 26/15, 15 prill 2015 (“Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës”). Shih gjithashtu vendimin për autorizimin për apel, para. 63.

por lidhja ndërmjet pikës së parë dhe të tretë të apelit dhe pikave të autorizuara për apel nuk është e drejtpërdrejtë.

35. Në lidhje me pikën e parë të apelit, Paneli vëren se ndonëse Veseli nuk argumentoi specifikisht në ndonjë prej parashtrimeve të mëparshme se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh cilësinë e ligjit sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së, ky argument ka lidhje me kundërshtimin qendror të bërë nga Veseli se, duke zbatuar DZN-në, Ligji krijon dy sisteme paralele në shkelje të parimit të barazisë para ligjit dhe për këtë arsye në shkelje të nenit 103(7) të Kushtetutës.¹⁰² Në kundërshtim me argumentin e ZPS-së se leja për apel për një çështje të ngjashme të ngritur nga Thaçi u refuzua,¹⁰³ argumentet e Thaçit në këtë aspekt kishin të bënin me garancitë e pavarësisë dhe paanshmërisë,¹⁰⁴ dhe jo “cilësisë së ligjit” si i tillë. Në lidhje me pikën e tretë të Apelit të Veselit, Paneli vëren se Veseli parashtroi në kërkesën për leje për apel se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi parashtrimet e tij në lidhje me faktorët e përdorur nga Komisioni i Venecias për përkufizimin e gjykatave të specializuara ose të jashtëzakonshme.¹⁰⁵ Paneli gjithashtu vëren se argumentet e tjera të parashtruara nga Veseli mbi çështje të tjera të ndryshme nga ato të pretenduara mbi shkeljen e barazisë¹⁰⁶ lidhen ose me pretendimin se Dhomat e Specializuara janë të paligjshme sipas nenit 103(7) të Kushtetutës ose me kundërshtimin kryesor për mbështetjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Për këtë arsye Trupi Gjykues konsideron se këto argumente janë të lidhura në mënyrë të pandashme me pikat dhe do t'i shqyrtojë si të tilla.

¹⁰² Shih kërkesën për autorizim për apel të Veselit, para 8-14. Shih vendimin për autorizim për apel, para. 64 (ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi se pika e autorizuar për apel ka lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtën e Veselit për gjykim të drejtë sipas neni6(1) të KEDNJ-së).

¹⁰³ Shih përgjigjen ndaj apelit të Veselit, para. 23.

¹⁰⁴ Shih vendimin për autorizimin për apel, paras 34-37; Kërkesa për autorizimin për apel e Thaçit, para 10, 15, referuar mocionit të Thaçit, para 36-43.

¹⁰⁵ Kërkesa për autorizim për apel e Veselit, para. 12, referuar mocionit të Veselit, para 13-19. Shih gjithashtu vendimin për autorizimin për apel, para. 61.

¹⁰⁶ Shih apelin e Veselit, para 44, 48-49.

36. Në lidhje me themelësinë e Apelit të Veselit, Trupi Gjykses vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës e përkufizoi gjykatën e specializuar, që është e lejueshme sipas nenit 103(7) të Kushtetutës, si gjykatë me një fushë juridiksioni të përcaktuar specifikisht që mbetet brenda kuadrit ekzistues të sistemit gjyqësor dhe operon në përputhje me parimet e saj, ndryshe nga një gjykatë e jashtëzakonshme e cila do të vendosej jashtë strukturës së sistemit ekzistues gjyqësor dhe do të operonte pa iu referuar atij.¹⁰⁷ Paneli më tej vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se e njëjta dispozitë kushtetuese kërkon që gjykata e specializuar të bazohet në ligj dhe themelimi i saj të jetë i domosdoshëm.¹⁰⁸ Më e rëndësishme, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se Dhomat e Specializuara i plotësojnë këto kritere.¹⁰⁹

37. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se Dhomat e Specializuara përputhen me kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së¹¹⁰ dhe me të drejtat kushtetuese të mbrojtura nga kapitujt II dhe III të Kushtetutës.¹¹¹ Paneli vëren se ndërkohë që sundimi i ligjit dhe shmangia e kompetencave arbitrare janë parime mbi të cilat mbështetet e gjithë KEDNJ-ja,¹¹² në kontekstin e nenit 6 të KEDNJ-së këto parime shërbejnë konkretisht “për të forcuar besimin publik në një sistem drejtësie objektiv dhe transparent, një prej themeleve të një shoqërie demokratike”.¹¹³ Siç konstatoi me të drejtë Gjykatësi i Procedurës

¹⁰⁷ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 42-43.

¹⁰⁸ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 45-48, 50-52.

¹⁰⁹ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 49, 54, 58, 68.

¹¹⁰ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 47-48, 54. Shih gjithashtu më poshtë, para. 47.

¹¹¹ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 44, 55-57, 59-66, 68.

¹¹² Shih Apelin e Veselit, para. 17, referuar GJEDNJ-së, *Lhermitte v. Belgium*, no. 34238/09, Judgment, 29 nëntor 2016 (“*Lhermitte v. Belgium Judgment*”), para 67, 69; GJEDNJ, *Parlov-Tkalčić v. Croatia*, no. 24810/06, Judgment, 22 dhjetor 2009 (“*Parlov-Tkalčić v. Croatia Judgment*”), para 86-89; ECtHR, *Moiseyev v. Russia*, no. 62936/00, Judgment, 9 tetor 2008 (“*Moiseyev v. Russia Judgment*”), para. 183; GJEDNJ, *Ramanauskas v. Lithuania*, no. 74420/01, Judgment, 5 shkurt 2008 (“*Ramanauskas v. Lithuania Judgment*”), para 51, 65; Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 11, referuar GJEDNJ-së, *Haidn v. Germany*, no. 6587/04, Judgment, 13 janar 2011, para. 79 (ku GJEDNJ-ja konfirmoi se “cilësia e ligjit’ [sipas nenit 5 të KEDNJ-së] nënkupton se, kur ligji vendor autorizon privimin nga liria, ai duhet të jetë mjaftueshëm i qasshëm, i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të evitohet rrezikun e arbitraritetit”).

¹¹³ *Lhermitte v. Belgium Judgment*, para. 67. Shih gjithashtu *Parlov-Tkalčić v. Croatia Judgment*, para 86-89 (ku GJEDNJ-ja konsideroi aspekte të pavarësisë gjyqësore si garanci në kuptimin e nenit 6(1) të

Paraprake, “objekti i termit ‘themeluar me ligj’ në nenin 6 është të garantojë që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike nuk është në diskrecionin e ekzekutivit, por rregullohet nga ligji që buron nga Parlamenti”.¹¹⁴ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake iu referua konstatimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës se kriteri “i krijuar me ligj” plotësohet nga fakti që ndryshimi i propozuar kushtetues nr. 24, tani neni 162 i Kushtetutës integroi Dhomat e Specializuara në sistemin e drejtësisë së Kosovës dhe kërkoi miratimin e një ligji të veçantë nga Kuvendi i Kosovës dhe vërejti se një ligj i tillë më vonë ishte miratuar dhe karakteristikat e tij në terma të përgjithshme ishin miratuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në kohën e duhur nëpërmjet Shkëmbimit të Letrave.¹¹⁵ Për këtë arsye, Paneli konsideron se këto aspekte arbitraret brenda kontekstit të nenit 6(1) të KEDNJ-së ishin shqyrtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

38. Gjithashtu, Paneli vëren se, ndërkohë që neni 6 i KEDNJ-së synon të ofrojë mbrojtje nga defektet procedurale,¹¹⁶ Veseli nuk provon se si i shkel ligji të drejtat e tij procedurale. Paneli gjithashtu gjkon se argumentet e Veselit se disa aspekte të Ligjit shkelin parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit¹¹⁷ nuk lidhen me kriterin “e krijuar me ligj” të nenit 6(1) të KEDNJ-së. Gjithsesi, Paneli rikujton se zbatueshmëria dhe

KEDNJ-së); *Moiseyev v. Russia* Judgment, para 183-185 (ku një shkelje e rregullit të pandryshueshmërisë së përbërjes së një gjykate u gjet si shkelje e pavarësisë dhe paanshmërisë e gjykatës sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së); *Ramanauskas v. Lithuania* Judgment, para 51, 65-66 (shyqrtimi nëse metodat hetimore shkelin të drejtat e gjykimit të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së).

¹¹⁴ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 86, që citon Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, paras 47-48, referuar GJEDNJ-së, *Fruni v. Slovakia*, nr. 8014/07, Judgment, 21 qershor 2011, para. 142; *Erdem v. Germany*, no. 38321/97, Decision, 9 dhjetor 1999. Shih gjithashtu GJEDNJ, *Richert v. Poland*, no. 54809/07, Judgment, 25 tetor 2011, para. 42.

¹¹⁵ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para 86-88, referuar Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 38, 45-53, 55.

¹¹⁶ Shih aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 80 (“Gjykata [Kushtetuese e Kosovës] vëren se ajo garanton që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të kujdesen për të gjithë elementët e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe për garancitë e tjera procedurale” (shtohet theksi)). Shih gjithashtu p.sh. GJEDNJ, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland*, no. 26374/18, Judgment, 1 December 2020 (“*Ástráðsson v. Iceland* Judgment”), para. 247 (“vetëm shkeljet që lidhen me rregullat themelore të procedurës për emërimin e gjykatësve ndikojnë në thelbin e të drejtës së mbrojtur nga neni 6 i KEDNJ-së dhe për pasojë ka gjasa që të rezultojnë në shkelje”).

¹¹⁷ Shih Apelin e Veselit, para 19-26.

epërsia e DZN-së nuk shkelin parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë para ligjit dhe çdo dallim në trajtim ndërmjet të akuzuarit para Dhomave të Specializuara dhe gjykatave të zakonshme në Kosovë është objektivisht dhe në mënyrë të arsyetuar e justifikuar duke pasur parasysh kuadrin e juridiksionit të përcaktuar nga nenet 6 deri 9 të Ligjit në lidhje me raportin e Këshillit të Evropës.¹¹⁸

39. Në lidhje me peshën që i jep Gjykatësi i Procedurës Paraprake Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Paneli vëren se neni 162(1) i Kushtetutës parasheh se: “Organizimi, funksionimi dhe *juridiksioni* i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me një ligj të veçantë” (theksi i shtuar). Gjithashtu, Shkëmbimi i Letrave, i cili kishte ndodhur tashmë në kohën kur Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori vendimin dhe lëshoi aktgjykimin e saj, gjithashtu i referohet Dhomave të Specializuara që rregullohen me anë të statutit të tyre.¹¹⁹ Gjithashtu, ndonëse përmbajtja e saktë e Ligjit nuk ishte e njohur në kohën e nxjerrjes së aktgjykimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ishte e vetëdijshme se juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së do të kishte të bënte me krime specifike.¹²⁰ Në këtë aspekt, Paneli vëren se Dhomat e Specializuara do të “funksionojnë brenda kuadrit të drejtësisë penale”¹²¹ i referohet integritetit strukturor të Dhomave të Specializuara brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.¹²² Në mënyrë të

¹¹⁸ Shih Vendimin e Apelit mbi Juridiksionin, para 44-47, 78-84.

¹¹⁹ Aktvendimi i DHSGJK-së për kërkesën referuese, para. 63 (“funksionimi në mënyrë autonome [i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së] sigurohet kryesisht përmes bartjes së disa kompetencave sovrane për aq kohë sa zgjatë mandati, çka sjellë edhe krijimin e kornizës së tyre ligjore”).

¹²⁰ Shih gjithashtu Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 54 (“[Dhomat e Specializuara janë] në përputhje me kriterin për të qenë të bazuar në ligj dhe të hyjnë në fushën e specializuar të juridiksionit”), 59 (“Struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të tjera, në pajtim me Kushtetutën”), 60 (“Fushëveprimi i juridiksionit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të jetë për të njëjtat krime specifike si dhe për Dhomat e Specializuara”), 68 (“[Gjykata Kushtetuese konstaton se ndërmjet katër elementëve të rinj strukturorë të futur në kushtetutë me ndryshimin është që ata do të] kenë një fushëveprim specifik të juridiksionit”), 71 (“këta elementë të rinj strukturorë në sistemin e drejtësisë së Kosovës bëhen me ligj dhe me qëllimin e luftimit të krimeve specifike”).

¹²¹ Shih Apelin e Veselit, para. 32, referuar Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 68.

¹²² Shih Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 36, 68 (ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi, në lidhje me kriterin “e krijuar me ligj” të nenit 103(7) të Kushtetutës, se katër elementët e

ngjashme, deklaratat e palëve ndërkombëtare të përfshira në proces të cilave u referohet Veseli¹²³ kanë gjithashtu të bëjnë me integrimin e Dhomave të Specializuara dhe krijimin e tyre nga ligji i Kosovës, dhe jo juridiksionin e tyre lëndor.

40. Në lidhje me kriterin e përdorur nga Komisioni i Venecias nëse një gjykatë ka kompetenca speciale ose ndjek procedura të veçanta të ndryshme nga ato të zbatuara në gjykatat ekzistuese penale,¹²⁴ Paneli vëren se Komisioni i Venecias u referohet “disa *indicia-ve* mbi bazën e të cilave *mund* të arrihet në përfundimin” se një gjykatë në parim mund të konsiderohet si gjykatë e specializuar, por në analizë të fundit ia lë gjykatës kushtetuese të vendosë mbi kushtetutshmërinë e ligjit.¹²⁵ Paneli vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e vendosi një kriter të tillë për përcaktimin nëse një gjykatë cilësohet si e specializuar ose e jashtëzakonshme në kuptimin e nenit 103(7) të Kushtetutës. Rrjedhimisht Paneli konsideron se fakti që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e shqyrtoi këtë kriter në arsyetimin e tij nuk mund të cilësohet si gabim.¹²⁶ Paneli gjithashtu vëren se jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut të cilave u referohet Veseli nuk mbështesin argumentet e tij se kuadri i zbatueshëm ligjor ka rëndësi për një vendimmarrje të tillë.¹²⁷

rinj strukturorë të futur në Kushtetutë me këtë ndryshim, që janë krijimi i Dhomave të Specializuara, ZPS-së, DHSGJK-së dhe Avokatit të Popullit të Dhomave të specializuara, do të “funksionojë brenda kuadrit ligjor të drejtësisë penale” dhe konfirmoi se krijimi i tyre vjen brenda sistemit ekzistues të drejtësisë së Kosovës). Shih Apelin e Veselit, para. 32, referuar Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 46, duke cituar nenin 21(2) të Ligjit mbi Gjykatat Nr. 03/L-199, icili në mënyrë të ngjashme ka të bëjë me vendosjen strukturore të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Supreme të Kosovës për aspekte që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës brenda Gjykatës Supreme.
¹²³ Shih Apelin e Veselit, para. 48.

¹²⁴ Komisioni i Venecias, nr. 896 / 2017, Opinion on the Draft Law on Anti-Corruption Courts and on the Draft Law on Amendments to the Law on the Judicial System and the Status of Judges (Në lidhje me prezantimin e specializimit të detyrueshëm të Gjykatësve për shqyrtimin e veprave të korrupsionit dhe që kanë të bëjnë me korrupsionin), 9 tetor 2017 (“Mendimi i Komisionit të Venecias”), para. 25.

¹²⁵ Mendimi i Komisionit të Venecias, para 22, 29 (shtohet theksi). Shih gjithashtu nenin 112(1) të Kushtetutës; nenin 49(1) të Ligjit.

¹²⁶ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para 10, 91 (ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake vërejti argumentet e Veselit mbi kriterin e “kompetencave speciale”).

¹²⁷ Apeli i Veselit, para 39-40, referua GJEDNJ-së, *Bahaettin Uzan v. Turkey*, no. 30836/07, Judgment, 24 nëntor 2020 (“*Uzan v. Turkey* Judgment”), para. 17; UNHRC, *Kavanagh v. Ireland*, CCPR/C/71/D/819/1998, 26 April 2001 (“*Kavanagh v. Ireland* Decision”), para 10.2-10.3. Referimet e

41. Në çdo rast, ligji i zbatueshëm në Dhomat e Specializuara është plotësisht në përputhje me Kushtetutën dhe rrjedhimisht Dhomat e Specializuara nuk kanë “kompetenca të veçanta” në mënyrën që sugjerohet nga Veseli.¹²⁸ Paneli gjithashtu vëren në këtë aspekt konstatimin e DHSGJK-së se *raison d’être* i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së dhe si pasojë e kuadrit të tyre ligjor është të realizojnë vetë kontekstin e tyre, të drejtat dhe liritë themelore përkatëse në lidhje me pretendimet e ngritura në Raportin e Këshillit të Evropës dhe proceset që lindin nga hetimet përkatëse të Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”).¹²⁹

42. Duke pasur parasysh sa më sipër, Paneli gjykon se Veseli nuk ka vërtetuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar nëse kuadri i të drejtës materiale çon në lindjen e pabarazisë sipas ligjit në shkelje të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës, duke e bërë Gjykatën “të paligjshme” në kuptimin e nenit 103(7). Rrjedhimisht Paneli i Gjykatës së Apelit hedh poshtë pikën e Veselit.

Veselit kanë të bëjnë ose me konstatimet e një gjykatë vendore në vend të GJEDNJ-së (shih *Uzan v. Turkey Judgment*, para. 17) ose nuk vendosin një ligj të ndryshëm të zbatueshëm si kriter për dallimin ndërmjet gjykatave të specializuara dhe gjykatave të jashtëzakonshme (shih *Uzan v. Turkey Judgment*, para. 53 (ku GJEDNJ-ja konstatoi se “Gjykata e 8-të e Asizit e Stambollit nuk ishte një “tribunal i jashtëzakonshëm” i krijuar [...] për t’u marrë specifikisht me çështjen e ankuesit” dhe konsideroi si karakteristika që e bënin gjykatën të specializuar: fakti që ajo veproi brenda strukturës ekzistuese të gjykatave të Asizit të Stambollit, që iu dha juridiksion për të marrë përsipër gjykimet në lidhje me të gjitha veprat penale përkatëse në provincën e Stambollit, u nënshtrohej të njëjtave rregulla të procedurës si të gjitha gjykatat e Asizit, dhe gjykatësit e emëruar në të gëzonin të njëjtat garanci dhe përfitime si të gjithë gjykatësit e gjykatave të Asizit”); *Kavanagh v. Ireland Decision*, para. 10.2 (ku Komiteti i të Drejtave të Njeriut vërejt se gjykata në fjalë ishte problematike pasi i mungonin disa procedura sipas ligjit të brendshëm dhe sepse ligji lejoi që çdo vepër tjetër të gjykohej nëse autoriteti kompetent kishte mendimin se gjykatat e zakonshme nuk ishin të përshtatshme për të siguruar administrimin efektiv të drejtësisë).

¹²⁸ Shih Vendimin e Apelit mbi juridiksionin, para 29, 40, 47. Shih gjithashtu Mendimin e Komisionit të Venecias, para 23-24 (ku Komisioni i Venecias vërejt se gjykata në fjalë nuk përbënte një gjykatë të jashtëzakonshme, duke konsideruar ndërmjet të tjerave se do të ishte kompetente për një numër të përgjithshëm të përkufizuar në mënyrë abstrakte veprash penale dhe autorësh të veprave penale).

¹²⁹ Aktvendimi i DHSGJK-së për Kërkesën Referuese, para. 56.

2. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori parasysh se, të marra së bashku, karakteristikat e Dhomave të Specializuara nuk plotësojnë në mënyrë strukturore kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së (pika e pestë e Thaçit)

(a) Parashtrimet e palëve

43. Thaçi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gaboi kur shqyrtoi individualisht dhe jo në mënyrë kumulative karakteristikat e Dhomave të Specializuara në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë, në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së.¹³⁰ Sipas Thaçit, këto karakteristika nënkuptojnë se Dhomat e Specializuara nuk arrijnë të plotësojnë në mënyrë strukturore kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së, duke e bërë kështu atë gjykatë të jashtëzakonshme.¹³¹

44. ZPS-ja përgjigjet se Thaçi më tepër argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar karakteristikat e Dhomave të Specializuara të ngritura nga Thaçi në mënyrë kumulative pasi i ka vlerësuar ato individualisht, dhe prandaj çdo gabim në këtë aspekt do të ishte i padëmshëm, pasi Thaçi nuk kundërshton vlefshmërinë e vendimmarrjes përfundimtare dhe Dhomat e Specializuara nuk shkelin nenin 6(1) të KEDNJ-së.¹³² ZPS-ja më tej parashtron se, duke qenë se të marra individualisht këto karakteristika nuk shkelën nenin 6(1) të KEDNJ-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte detyrimin për t'i vlerësuar në mënyrë kumulative.¹³³ Sipas ZPS-së, jurisprudenca e GJEDNJ-së të cilës i referohet Thaçi nuk mbështet argumentin e tij se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet t'i kishte trajtuar këto karakteristika në mënyrë kumulative.¹³⁴

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se, gjatë vlerësimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së një gjykate apo tribunali, duhet të shqyrtohet ndër të tjera

¹³⁰ Apeli i Thaçit, para 7-10. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para 2-6.

¹³¹ Apeli i Thaçit, para. 6.

¹³² Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para. 38.

¹³³ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 39, 42-43.

¹³⁴ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 39-41, 44.

mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, kohëzgjatja e mandatit, ekzistenca e garancive ndaj presionit të jashtëm si dhe nëse organi shfaq imazhin e pavarësisë.¹³⁵ Ai më tej konfirmoi se pa konstatimin e një shkeljeje të kuadrit ligjor që rregullon Dhomat e Specializuara, ekziston një prezumim i fortë i pavarësisë dhe paanshmërisë.¹³⁶

46. Paneli vëren se ndryshe nga argumentet e Thaçit,¹³⁷ GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar se ekziston detyrimi për të shqyrtuar nëse, në mënyrë kumulative, karakteristikat e një gjykate nënkuptojnë se ajo nuk mund të konsiderohet e paanshme ose e pavarur ose e krijuar me ligj. Përkundrazi, duke qenë “të vetëdijshëm për vështirësitë që përfshin krijimi i një testi të ekuilibruar për t’u marrë me parregullsitë e mundshme që mund të lindin në procesin e emërimeve gjyqësore në juridiksionet e ndryshme”, GJEDNJ-ja konstatoi se ekzistojnë tre kritere të cilat të marra në mënyrë kumulative japin një bazë të fortë “për vlerësimin nëse parregullsitë në një proces emërimi gjyqësor kanë një peshë të tillë sa të përbëjnë shkelje të së drejtës së një tribunali të krijuar me ligj dhe nëse ishte vendosur ekuilibri i duhur proporcional ndërmjet parimeve konkurruese nga autoritetet përkatëse shtetërore në rrethanat e veçanta të çështjes.”¹³⁸ Këto tri kritere janë: (i) duhet të ekzistojë në parim një shkelje objektivisht dhe vërtet e identifikueshme e të drejtës vendore; (ii) shkelja në fjalë duhet të vlerësohet duke pasur parasysh objektin dhe qëllimin e kriterit të një “tribunali të krijuar me ligj”; dhe (iii) duhet të shqyrtohet nëse këto pretendime në lidhje me të

¹³⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 100, referuar GJEDNJ-së, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina*, nos 2312/08 and 34179/08, Judgment, 18 July 2013, para. 49.

¹³⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 101, referuar GJEDNJ-së, *Kyprianou v. Cyprus*, no. 73797/01, Judgment, 15 December 2005, para. 119.

¹³⁷ Apeli i Thaçit, para. 10, referuar *Ástráðsson v. Iceland* Judgment, para. 243 et seq.; GJEDNJ, *Reczkoëicz v. Poland*, no. 43447/19, Judgment, 22 July 2021 (“*Reczkoëicz v. Poland* Judgment”), para 216-224; GJEDNJ, *Dolińska - Ficek and Ozimek v. Poland*, nos 49868/19, 57511/19, Judgment, 8 November 2021 (“*Dolińska - Ficek and Ozimek v. Poland* Judgment”), para 272-280.

¹³⁸ *Ástráðsson v. Iceland* Judgment, para 243-252; *Reczkoëicz v. Poland* Judgment, paras 216-224; *Dolińska - Ficek and Ozimek v. Poland* Judgment, para 272-280.

drejtën për një “tribunal të krijuar me ligj” u rishikuan dhe u ndreqën në mënyrë efektive nga gjykatat e brendshme.¹³⁹

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kreu vlerësimin e të gjitha karakteristikave të kundërshtuara nga Thaçi dhe arriti në përfundimin se asnjë prej tyre nuk vë në dyshim pavarësinë dhe paanshmërinë e Dhomave të Specializuara.¹⁴⁰ Në këtë aspekt, Paneli vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se, në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Dhomat e Specializuara “janë [...] në përputhje me kriterin për të qenë të mbështetura në ligj” dhe prandaj “ [ndryshimi kushtetues nr. 24] përputhet me kriteret për një tribunal të pavarur dhe të paanshëm siç parashihet nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së”.¹⁴¹

48. Pasi është konstatuar se asnjë prej karakteristikave të Dhomave të Specializuara nuk shkel parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë, është logjikisht e pamundur të gjykohet se kjo mund të ndodhë në mënyrë kumulative. Që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të angazhohej në vlerësimin e ndikimit kumulativ të këtyre tipareve, ai duhet të kishte konstatuar, të paktën, disa parregullsi ose defekte që nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e kërkesës për një “tribunal të krijuar me ligj” kur i vlerëson secilën prej tyre individualisht – gjë që ai nuk e bëri.¹⁴²

¹³⁹ *Ástráðsson v. Iceland* Judgment, para 243-252; *Reczkoëicz v. Poland* Judgment, para 216-224; *Dolińska - Ficek and Ozimek v. Poland* Judgment, para 272-280.

¹⁴⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para 101-111.

¹⁴¹ Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 54.

¹⁴² *Ástráðsson v. Iceland* Judgment, Joint Partly Concurring, Partly Dissenting Opinion of Judges O’Leary, Ravarani, Kucsko-Stadlmayer and Ilievski, para. 51 (“A series of shortcomings that, considered together, lead to the finding of a violation of Article 6 § 1”); GJEDNJ, *Mirilashvili v. Russia*, no. 6293/04, Judgment, 11 dhjetor 2008 (“*Mirilashvili v. Russia* Judgment”), paras 164-165 (“the [ECtHR] often assesses to what extent the defects complained of prejudiced the overall fairness of the trial, particularly with regard to the taking of evidence”); ECtHR, *Barberà, Messegue and Jabardo v. Spain*, no. 10590/83, Judgment, 6 December 1988, para. 89 (konstatimi se “procesi në fjalë i marrë në tërësi nuk plotësoi kërkesat për një seancë të drejtë dhe publike” pasi konstatoi një sërë shkeljesh procedurale, përfshirë “transferimin e vonuar të ankuesve nga Barcelona në Madrid, ndryshimi i papritur i anëtarëve të gjykatës menjëherë para hapjes së seancës, kohëzgjatja e shkurtër e procesit dhe mbi të gjitha fakti që pjesë të ndryshme të provave nuk u paraqitën dhe nuk u diskutuan në proces në praninë e ankuesit dhe nën syrin vëzhgues të publikut”); ECtHR, *Ibrahim and others v. United Kingdom*, nos 50541/08,

49. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli konstaton se Thaçi nuk ka provuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke mos shqyrtuar se, marrë në mënyrë kumulative, karakteristika e Dhomave të Specializuara nuk përmbushin nenin 6(1) të KEDNJ-së. Paneli i Gjykatës së Apelit rrjedhimisht hedh poshtë pikën e pestë të Thaçit.

3. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se periudha përkatëse për t'u gjykuar brenda një periudhe të arsyeshme filloi vetëm më 17 nëntor 2019 (pika e shtatë e Thaçit)

(a) Parashtrimet e Palëve

50. Thaçi parashtroi se GJEDNJ-ja ka konstatuar se akuza penale ekziston për qëllimin e përcaktimit të arsyeshmërisë së periudhës së gjyqit sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së ku personi është “thelbësisht i ndikuar” nga veprimet e autoriteteve.¹⁴³ Thaçi argumenton se ai është ndikuar thelbësisht nga të paktën data e publikimit të raportit të Këshillit të Evropës më 7 janar 2011 dhe pretendimi se ai nuk është hetim penal është i parëndësishëm.¹⁴⁴ Sipas Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi një “interpretim kufizues në mënyrë të gabuar të jurisprudencës së GJEDNJ-së” duke u mbështetur në dy çështje që nuk kanë paralele faktike të perceptueshme me çështjen aktuale.¹⁴⁵ Kjo qasje cenohet, sipas pikëpamjes së Thaçit, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së e cila kërkon një lexim të gjerë të nenit 6(1) të KEDNJ-së.¹⁴⁶

50571/08, 50573/08, 40351/09, Judgment, 13 shtator 2016 (“*Ibrahim and others v. UK Judgment*”), para. 311 (“having regard to the cumulative effect of the procedural shortcomings [...], the [ECtHR] considers that the Government have failed to demonstrate *ëhy* the overall fairness of the trial *ëas* not irretrievably prejudiced by the decision not to caution [the applicant] and to restrict his access to legal advice”). Shih gjithashtu *Mirilashvili v. Russia* Judgment, para. 166 (“the Court *may* have to examine separately each limb of the applicant’s complaint and then make an overall assessment” (emphasis added)). Contra Apeli i Thaçit, para. 10. Shih gjithashtu gjithashtu më lart poshtëshënimin 139.

¹⁴³ Apeli i Thaçit, para 12-14. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 7. Kjo qasje fleksibël ndaj pikës fillestare për përlllogaritjen e arsyeshmërisë së periudhës së gjykimit, sipas Thaçit, gjithashtu e përkrahur nga gjykatat penale ndërkombëtare. Shih Apelin e Thaçit, para. 15.

¹⁴⁴ Apeli i Thaçit, para 16, 22. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para 21, 23-24; Kundërpërgjigjen e Thaçit, para 8, 12.

¹⁴⁵ Apeli i Thaçit, para 16-18. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para 23, 25; Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 11.

¹⁴⁶ Apeli i Thaçit, para. 20. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para 19, 25.

51. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Thaçit që bëhen në kontekstin e pretendimeve se shkelja e të drejtave të tij përligj hedhjen poshtë të juridiksionit të Dhomave të Specializuara në rastin e tij “nuk i afrohen fare standardit” të të qenit raste të jashtëzakonshme të shkeljeve shumë të rënda të të drejtave të njeriut, që do të ishin arsyet e vetme që mund të përligjin hedhjen poshtë të juridiksionit.¹⁴⁷ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se Thaçi keqinterpretonte Vendimin e Kundërshtuar duke qenë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake identifikoi me saktësi dhe zbatoi standardin përkatës për përcaktimin se kur ngrihet “akuzë” në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së.¹⁴⁸ ZPS-ja gjithashtu argumenton se përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se “asnjë akuzë penale” në kuptimin e nenit 6 nuk u ngrit në kohën e publikimit të raportit të Këshillit të Evropës ishte i saktë dhe i arsyeshëm, duke qenë se nuk është e mjaftueshme që të ngrihet një pretendim ose të ndërmerret një veprim nga një organ i ndryshëm nga autoriteti kompetent me fuqi zbatuese në lidhje me akuzën.¹⁴⁹

52. Në kundërpërgjigje, Thaçi parashtron se nocioni i “autoritetit kompetent” nuk ka bazë në jurisprudencën e GJEDNJ-së në lidhje me kriterin e “ndikimit thelbësor”.¹⁵⁰ Sipas Thaçit, ZPS—ja mundohet të nxisë vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake i cili gjithsesi nuk u mbështet në teorinë e “autoritetit kompetent”.¹⁵¹

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

53. Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi se pika fillestare e periudhës që duhet marrë parasysh për të përcaktuar “kohë e arsyeshme” sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së është kur një individ njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për pretendimin se ai ose ajo ka kryer një vepër penale ose nga momenti kur situata e tij ose e saj është ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si

¹⁴⁷ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 14-15.

¹⁴⁸ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 47-48, 51. ZPS-ja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk zgjodhi si pikë fillestare datën formale të njoftimit të akuzave apo të synimit për ndjekje penale. Shih Përgjigjen ndaj Apelit të Thaçit, para. 51.

¹⁴⁹ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 49-50, 52.

¹⁵⁰ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 9.

¹⁵¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10.

rezultat i një dyshimi kundër tij.¹⁵² Paneli gjithashtu vëren se, ndërkohë që Thaçi nuk bie dakord me këtë standard, ai argumenton se ai është ndikuar thelbësisht që nga publikimi i Raportit të Këshillit të Evropës më 7 janar 2011 në vend të 17 nëntorit 2019, data në të cilën iu dorëzua thirrja për t'u marrë në pyetje nga ZPS-ja, e zgjedhur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁵³

54. Paneli, gjithsesi, gjykon se qasja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke përfshirë çështjet e cituara nga Thaçi.¹⁵⁴ GJEDNJ-ja specifikisht konfirmoi se:

“[K]oha e arsyeshme” të cilës i referohet neni 6(1) fillon të llogaritet sapo një person “akuzohet”; kjo mund të ndodhë në një datë para se çështja të fillojë para gjykatës, si në datën e arrestimit, datën në të cilën personi në fjale është njoftuar zyrtarisht se ai do të ndiqej penalisht ose ditën e hapjes së hetimeve paraprake. Gjithashtu, akuza, në kuptimin e nenit 6(1), mund të përkufizohet si “njoftimi zyrtar që i jepet një individ nga autoriteti kompetent i pretendimit se ai ka kryer një vepër penale”, përkufizim që gjithashtu i korrespondon standardit nëse situata e të dyshuarit është ndikuar thelbësisht.¹⁵⁵

¹⁵² Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 123, referuar *Ibrahim and others v. UK* Judgment, para. 249; ECtHR, *Liblik and Others v. Estonia*, nos 173/15, 181/15, 374/15, 383/15, 386/15 and 388/15, Judgment, 28 May 2019, para. 90.

¹⁵³ Shih Apelin e Thaçit, para. 16, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 125. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 126.

¹⁵⁴ Shih Apelin e Thaçit, para 13-14.

¹⁵⁵ GJEDNJ, *Etcheveste and Bidart v. France*, nos 44797/98 and 44798/98, Judgment, 21 mars 2002, para. 77; ECtHR, *Reinhardt and Slimane-KSi sheaid v. France*, nos 23043/93 and 22921/93, Judgment, 31 March 1998 (“*Reinhardt and Slimane-Kaïd v. France* Judgment”), para. 93; GJEDNJ, *Hozee v. the Netherlands*, no. 21961/93, Judgment, 22 May 1998, para. 43. Shih gjithashtu GJEDNJ, *Farzaliyev v. Azerbaijan*, no. 29620/07, Judgment, 28 May 2020, paras 47-48 (ku GJEDNJ konstatoi se, ndonëse parashtruesi nuk u akuzua kurrë formalisht për një vepër penale, u vu në dijeni të pretendimeve kundër tij me pushimin e procesit penal pasi u ngrit një padi civile kundër tij dhe gjykoi se, “në rrethanat e veçanta” të çështjes të kombinuara me efektin e veprimeve të autoriteteve të ndërmarra si rezultat i dyshimit kundër parashtruesit, ishte se gjendja e tij ishte “e ndikuar thelbësisht”); GJEDNJ, *Beuze v. Belgium*, no. 71409/10, Judgment, 9 November 2018, para. 119 (ku u konstatua se parashtruesi ishte ndikuar thelbësisht nga veprimet e ndërmarra nga autoritetet si pasojë e dyshimit kundër tij), referuar GJEDNJ, *Simeonovi v. Bulgaria*, no. 21980/04, Judgment, 12 May 2017, para. 110 (ku GJEDNJ renditi si shembuj konkretë: personi i arrestuar për shkak të dyshimit të kryerjes së një vepre penale, i dyshuari i marrë në pyetje për përfshirjen e tij në veprime që përbëjnë vepra penale dhe një person që është akuzuar formalisht sipas procedurës së përcaktuar në ligjin vendor për një vepër penale) dhe *Ibrahim and others v. UK*

55. Si shembuj të asaj që GJEDNJ-ja ka pranuar si “thelbësisht të ndikuar”, Thaçi vetë përmend datën kur shtëpia dhe zyrat e të dyshuarit u kontrolluan ose kur një i dyshuar merret në pyetje nga oficerët doganorë.¹⁵⁶ Paneli vëren se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale të cilës i referohet Thaçi për të mbështetur faktin se gjykatat ndërkombëtare penale përkrahën një interpretim të zgjeruar të “kohës së arsyeshme” është në fakt një mendim pakice që në mënyrë të ngjashme i referohet të drejtës së të akuzuarit për t’u gjykuar pa vonesë të paarsyeshme në “*të gjitha fazat e çështjes*, që nga koha që i dyshuari informohet se autoritetet po ndërmarrin hapa drejt ndjekjes penale”.¹⁵⁷

56. Duke pasur parasysh këtë, Paneli vëren se, ndërkohë që veprimet e pranuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së si pika fillestare në kuptimin e “kohës së arsyeshme” nuk përbëjnë domosdoshmërisht një njoftim formal që individit në fjalë do të ndiqet

Judgment, para. 249 (ku GJEDNJ-ja konstatoi se një prej parashtruesve nuk ishte i ndikuar thelbësisht kur u mor në pyetje si dëshmitar, pasi në atë fazë policia nuk dyshoi për përfshirjen e tij në veprën penale, por ai u bë i tillë gjatë intervistës kur ai filloi të akuzonte vetveten, duke qenë se në atë moment dyshimi se ai kishte kryer një veprë penale ishte kristalizuar, shih *Ibrahim and others v. UK* Judgment, para. 296); GJEDNJ, *Kagastuoma v. Finland*, no. 48339/99, Judgment, 20 January 2004, para. 26 (duke marrë parasysh se parashtruesi zyrtarisht mori dijeni për hetimin në momentin që u mor në pyetje nga policia për herë të parë); GJEDNJ, *Heaney and McGuinness v. Ireland*, no. 34720/97, Judgment, 21 December 2000, paras 10, 42 (parashtruesit “u ndikuan thelbësisht” dhe për pasojë “u akuzuan” ditën kur u morën në pyetje nga policia); GJEDNJ, *Foti and others v. Italy*, nos 7604/76, 7719/76, 7781/77, 7913/77, Judgment, 10 December 1982, para. 53 (duke konsideruar si datë fillestare datën pas nisjes së procesit kundër parashtruesve).

¹⁵⁶ Shih apelin e Thaçit, para. 14, referuar GJEDNJ, *Coeme and others v. Belgium*, nos 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 and 33210/96, Judgment, 22 June 2000, para. 133; GJEDNJ, *Diamantides v. Greece*, no. 60821/00, Judgment, 23 October 2003, para. 21; *Reinhardt and Slimane-Kaïd v. France* Judgment, para. 93; GJEDNJ, *Bertin-Mouroit v. France*, no. 36343/97, Judgment, 2 August 2000, para. 53.

¹⁵⁷ Shih Apelin e Thaçit, para. 15, referuar ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-3436-AnxI, Judgment pursuant to article 74 of the Statute, Minority Opinion of Judge Christine Van den Wyngaert, 7 March 2014 (“Opinion in Katanga Judgment”), para. 121 (shtohet theksi). Shih gjithashtu Schabas, W., and McDermott, Y., “Article 67”, in Ambos, K. (ed.), *Rome Statute of the International Criminal Court: Article-by-Article Commentary*, C.H.Beck, Hart, Nomos 2022 (Fourth Edition), p. 1981, marginal numbers 25-26 (stating that “[c]ase law and academic comment on the provision of the International Covenant on Civil and Political Rights [which is identical to Article 67(1)(c) of the ICC Statute providing that an accused shall be entitled to be tried without undue delay] have considered that the time limit begins to run at the moment the suspect or the accused is informed that the authorities are taking steps towards prosecution”). Notably, in the Opinion in Katanga Judgment, Judge Van den Wyngaert expressly states that “reasonableness of the length of the proceedings must be assessed in the light of the particular circumstances of the case [including] in particular the complexity of the case”. See Impugned Decision, paras 128-129.

penalisht nga një autoritet gjyqësor, të gjitha ato përbëjnë hapa të ndërmarra nga autoritetet në lidhje me hetimin për një veprë penale për të cilën është dyshuar individ. Këto akte në pikëpamjen e Panelit nuk janë të krahasueshme me publikimin e Raportit të Këshillit të Evropës. Në këtë kontekst Paneli konsideron se ka rëndësi që Raporti pranon se ai nuk është hetim penal.¹⁵⁸ Gjithashtu, jurisprudenca e GJEDNJ-së i referohet veprimeve të ndërmarra nga policia, prokuroria ose gjyqësori dhe prandaj Këshilli i Evropës nuk është lloji i autoritetit kompetent veprimet e të cilit do të merreshin në konsideratë me qëllim përlllogaritjen e “kohës së arsyeshme”.¹⁵⁹ Fakti që raporti i një organizate ndërkombëtare paraprin hetimin penal të kryer nga ZPS-ja është një veçanti e llojit të krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari, të cilat janë me interes për komunitetin ndërkombëtar në tërësi dhe si të tilla, motivuan veprimin e Këshillit të Evropës.¹⁶⁰ Nëse do të pranohej pikëpamja e Thaçit, pika fillestare për llogaritjen e kriterit të “kohës së arsyeshme” do të ishte mjaft e parakohshme, duke qenë se është e zakonshme në kontekstin e drejtësisë ndërkombëtare penale që lloje të ndryshme raportesh zyrtare ose private të përgatiten në lidhje me personat që pretendohet si janë përfshirë në krime ndërkombëtare.

57. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake se data kur Thaçit iu dorëzua fletëthirrja për t'u marrë në pyetje nga ZPS-ja për shkak të dyshimit kundër tij është data në të cilën Thaçi “u ndikua thelbësisht”¹⁶¹ është në përputhje të plotë me jurisprudencën e GJEDNJ-së pasi kjo datë përfaqëson kontaktin e parë të autoriteteve kompetente në hetimin penal që përfshinte

¹⁵⁸ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 125. Shih gjithashtu Raportin e Këshillit të Evropës, para 21, 175; Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 51 (ku Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se Raporti i Këshillit të Evropës përshkruan një numër pretendimesh kriminale shumë specifike dhe rekomandon hetimin dhe ndjekjen penale të tyre); Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin, para 69-70. Përdorimi i termit “zbulim” i referohet informacionit të dhënë nga ish-Kryeprokurojta e TPNJ-së Carla del Ponte, dhe jo informacionit të përfshirë në raportin e Këshillit të Evropës (contra Apeli i Thaçit, para. 22).

¹⁵⁹ Shih më lart, poshtëshënimet 155-156. Shih gjithashtu Vendimi i Kundërshtuar, para. 123.

¹⁶⁰ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, Rezoluta 1782 (2011), Hetimi i pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë, 25 janar 2011, para. 14.

¹⁶¹ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 126.

konkretisht të akuzuarin. Paneli vëren në këtë aspekt se kjo ndodhi shumë kohë para arrestimit të të akuzuarit, që ndodhi më 5 nëntor 2020, dhe, si e tillë shumë kohë para se të akuzuarit të merrnin njoftimin se ata do të ndiqeshin penalisht.

58. Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli konstaton se Thaçi nuk ka arritur të tregojë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke konstatuar se periodha e relevante për t'u gjykuar filloi më 17 nëntor 2019. Paneli i Gjykatës së Apelit, rrjedhimisht, hedh poshtë pikën e shtatë të Thaçit.

4. Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se përfshirja e Raportit të Këshillit të Evropës ndërmjet “Dokumenteve Themeluese” të Dhomave të Specializuara nuk shkeli prezumimin e pafajësisë (pika e tetë e Thaçit)

(a) Parashtrimet e Palëve

59. Thaçi argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se përfshirja e Raportit të Këshillit të Evropës në “Dokumentet Themeluese” të Dhomave të Specializuara nuk ka ndikim në prezumimin e pafajësisë së Thaçit.¹⁶² Sipas Thaçit, ndërkohë që raportet e Kombeve të Bashkuara (“KB”) kanë dhënë shtysën për krijimin e gjykatave penale, asnjë prej tyre nuk është “as afër gjuhës acaruese dhe përjashtuese dhe dënimit publik të individëve”, përfshirë Thaçin, si Raporti i Këshillit të Evropës, që është përkrahur nga Dhomat e Specializuara nëpërmjet publikimit në faqen e tyre të internetit.¹⁶³ Thaçi gjithashtu argumenton se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Raporti i Këshillit të Evropës nuk është përdorur për të mbështetur akuzat penale është i pasaktë dhe Thaçi nuk mund të verifikojë masën e plotë të këtij gabimi.¹⁶⁴ Thaçi, së fundmi, parashtron se, duke qenë Raporti i Këshillit të Evropës

¹⁶² Apeli i Thaçit, para 27, 32.

¹⁶³ Apeli i Thaçit, para 27-28. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para. 26.

¹⁶⁴ Apeli i Thaçit, para. 29. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 13. Thaçi gjithashtu parashtron se, nëse Raporti i Këshillit të Evropës nuk është përdorur për të mbështetur akuzat, atëherë

ndërmjet “Dokumenteve Themeluese” të Dhomave të Specializuara dhe një “fushate shoqëruese dhe të bashkërenduar të medias”, ai përballet me pengesa konkrete në përgatitjen e mbrojtjes së tij.¹⁶⁵

60. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e Thaçit, të cilat janë bërë në kontekstin e pretendimeve se shkelja e të drejtave të tij për ligj faktin që Dhomat e Specializuara të hedhë poshtë juridiksioni mbi të, “as nuk i afrohen standardit” të të qenit raste të jashtëzakonshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut që do të ishte arsyeja e vetme që mund të justifikonte hedhjes poshtë të juridiksionit.¹⁶⁶ Më tej, ZPS-ja parashtron se Thaçi kërkon të anashkalojë rregullën 77 të Rregullores, pasi leja për apel u dha vetëm për ndikimin e përfshirjes së Raportit të Këshillit të Evropës në “Dokumentet Themeluese” të Dhomave të Specializuara dhe nuk përshin kundërshtitë në lidhje me natyrën e raportit ose të ndikimit të tij në prezumimin e pafajësisë së të akuzuarve.¹⁶⁷ Sipas ZPS-së, Thaçi në mënyrë të përsëritur përqendrohet në rrethana të pavarura nga Dhomat e Specializuara dhe si të tilla, jashtë fushëveprimit të pikës së autorizuar për apel.¹⁶⁸

61. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Thaçi mundohet të përshkruajë çdo referencë ndaj raportit si përkrahje të pavend të pretendimeve kriminale ndërkohë që vendosja e tij në faqen e internetit nuk tregon asgjë më shumë se sa faktin që ai është një dokument që përbën pjesë të kuadrit ligjor që rregullon juridiksionin e Dhomave të Specializuara.¹⁶⁹ Së fundmi ZPS-ja argumenton se nuk ka asgjë të papërshtatshme ose paragjykuese në referimin ose vënien e raportit në dispozicion në faqen e internetit

duhet të publikohet me vërejtjen se pretendimet aty janë të pabazuara. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, para. 30; Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 14.

¹⁶⁵ Apeli i Thaçit, para. 31. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para 14-16.

¹⁶⁶ Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit, para 14-15.

¹⁶⁷ Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit, para 55-56.

¹⁶⁸ Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit, para. 57.

¹⁶⁹ Përgjigja ndaj Apelit të Thaçit, para 58-59.

dhe se parashtrimi i vetëm i Thaçit për paragjykim “qartësisht nuk ka lidhje” me asnjë akt të Dhomave të Specializuara ose ZPS-së.¹⁷⁰

62. Thaçi përgjigjet se ngritja e Raportit të Këshillit të Evropës në nivelin e një “Dokumentit Themelues” është një klasifikim ligjor i cili nuk mund të gjendet në Kushtetutë, Ligj ose Rregullore.¹⁷¹ “Mbështetja e përgjithshme” në pretendimet e raportit dhe ngritja e nivelit në mënyrë të vazhdueshme nga institucioni, cenon sipas Thaçit prezumimin e pafajësisë së tij.¹⁷²

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

63. Fillimisht, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se një pjesë e pikës për të cilin kërkohet leja për apel, siç ishte formuluar fillimisht, nuk ishte e apeluar pas ajo shtrembëronte Vendimin e Kundërshtuar.¹⁷³ Rrjedhimisht Paneli konsideron se argumentet e Thaçit se (i) Raporti i Këshillit të Evropës është përkrahur nga Dhomat e Specializuara nëpërmjet publikimit në faqen e tyre të internetit¹⁷⁴ dhe është lartësuar vazhdimisht,¹⁷⁵ dhe (ii) konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Raporti i Këshillit të Evropës nuk është përdorur për të mbështetur akuzat penale është i pasaktë dhe Thaçi nuk mund të verifikojë masën e këtij gabimi,¹⁷⁶ ka të bëjë me çështje që dalin jashtë fushës së riformuluar të pikës së autorizuar për apel. Rrjedhimisht, Paneli nuk do t'i shqyrtojë këto argumente.

¹⁷⁰ Përgjigjja ndaj Apelit të Thaçit, para 60-61.

¹⁷¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 15.

¹⁷² Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 16.

¹⁷³ Vendimi i Lejes për Apel, para. 57, referuar Vendimit të Kundërshtuar, para. 141. Pika për të cilën Thaçi kërkoi leje për apel ishte: “Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin e shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi në lidhje me vetë Raportin e [Këshillit të Evropës], duke mos shqyrtuar argumentet e Mbrojtjes se shkelja buron nga përcaktimi [nga Dhomat e Specializuara] i vetes në kuadër të një raporti që dënon të akuzuarit dhe nga bekimi që [Dhomat e Specializuara] dhe ZPS-ja i japin Raportit”. Shih Vendimin e Lejes për Apel, para. 6(8).

¹⁷⁴ Apeli i Thaçit, para. 28.

¹⁷⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 16.

¹⁷⁶ Apeli i Thaçit, para 29-30; Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 13.

64. Duke iu kthyer themelësisë, Paneli vëren se Raporti i Këshillit të Evropës është i renditur në paraqitjen në internet të Dhomave të Specializuara si “Dokumentet Themeluese” të Dhomave të Specializuara së bashku me Shkëmbimin e Letrave, ndryshimin kushtetues të nenit 162 të Kushtetutës dhe marrëveshjes me shtetin pritës ndërmjet Holandës dhe Kosovës si dhe variantin e saj të përkohshëm.¹⁷⁷ Paneli vëren se struktura dhe organizimi i faqes së internetit thjesht shërben si një orientim i lehtë për përdoruesit që e vizitojnë atë. Është e kuptueshme se ky organizim praktik nuk ka asnjë pasojë ligjore.

65. Gjithashtu, Paneli vëren se të gjithë dokumentet e renditur si “Dokumente Themeluese” kanë të bëjnë me mandatin dhe themelimin e Dhomave të Specializuara. Paneli vëren se, në këtë aspekt, Dhomat e Specializuara u krijuan shprehimisht në mënyrë që Kosova t’i respektojë detyrimet ndërkombëtare në lidhje me pretendimet e raportuara në Raportin e Këshillit të Evropës dhe të cilave u referohen neni 162 të Kushtetutës dhe nenet 1(2) dhe 2 të Ligjit.¹⁷⁸ Megjithatë, Raporti i Këshillit të Evropës nuk është një dokument ligjor ose një dokument që në çfarëdo formë përkufizon të drejtën materiale të zbatueshme ndaj Dhomave të Specializuara.¹⁷⁹

66. Gjithashtu, GJEDNJ-ja konstatoi se duhet të bëhet një dallim themelor ndërmjet deklaratës se dikush thjesht dyshohet se ka kryer një krim dhe një deklaratë të qartë se një individ ka kryer krimin në fjalë në mungesë të shpalljes përfundimtare si fajtor.¹⁸⁰ Paneli vëren në këtë aspekt se Raporti i Këshillit të Evropës qartëson se

¹⁷⁷ Shih <<https://www.scp-ks.org/en/documents/foundational-documents>> të parë më 19 maj 2022.

¹⁷⁸ Neni 162(1) të Kushtetutës; Nenet 1(2), 2, 5 të Ligjit. Shih gjithashtu nenin 6(1) të Ligjit (i cili parasheh se Dhomat e Specializuara do të kenë juridiksionin mbi veprat penale brenda juridiksionit lëndor që ka lidhje me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës). Shkëmbimi i Letrave përfshiu detyrimet ndërkombëtare të Kosovës që buronin nga Këshilli i Evropës. Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para. 51. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, para 37-39; Vendimi i Apelit mbi Juridiksionin, para. 68.

¹⁷⁹ Shih nenin 3(2)-(4) të Ligjit (në lidhje me burimet e ligjit të zbatueshëm).

¹⁸⁰ GJEDNJ, *Ismoilov and others v. Russia*, no. 2947/06, Judgment, 24 prill 2008 (“*Ismoilov and others v. Russia Judgment*”), para. 166; ECtHR, *Nešćák v. Slovakia*, no. 65559/01, Judgment, 27 February 2007, para. 89.

informacioni i dhënë përmban thjesht pretendime¹⁸¹ dhe se TFHS-ja dhe ZPS-ja kanë zhvilluar hetime të pavarura për pretendimet për krime në Raportin e Këshillit të Evropës.¹⁸²

67. Siç konstatoi Gjykatësi i Procedurës Paraprake, prezumimi i pafajësisë do të shkelej nëse deklarata e një personi zyrtar në lidhje me një person të akuzuar për kryerjen e veprave penale reflekton mendimin se ai ose ajo është fajtor para se një gjë e tillë të jetë provuar në përputhje me ligjin, pavarësisht nëse kjo deklaratë është bërë para gjyqit penal ose një tjetër forumi publik.¹⁸³ Paneli gjithashtu vëren se GJEDNJ-ja konstatoi se neni 6(2) i KEDNJ-së synon parandalimin e cenimit të procesit të drejtë penal me deklarata paragjyquese të bëra në lidhje të ngushtë me procesin penal, në mënyrë që atje ku nuk ka ose nuk ka pasur proces penal, deklaratat që atribuojnë sjellje penale ose sjellje tjetër të dënueshme nuk janë relevante për shqyrtimet në lidhje me prezumimin e pafajësisë.¹⁸⁴ Paneli vëren se në kohën kur u publikua raporti i Këshillit të Evropës nuk kishte hetime penale.¹⁸⁵

¹⁸¹ Raporti i Këshillit të Evropës, para 1, 16, 174-175.

¹⁸² Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 140.

¹⁸³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 136, referuar GJEDNJ-së, *Allen v. the United Kingdom*, no. 25424/09, Judgment, 12 July 2013 (“*Allen v. the United Kingdom Judgment*”), para. 93; GJEDNJ, *Daktaras v. Lithuania*, no. 42095/98, Judgment, 10 October 2000, para. 41; GJEDNJ, *Allenet de Ribemont v. France*, no. 15175/89, Judgment, 10 February 1995, para. 36; GJEDNJ, *Kemal Coşkun v. Turkey*, no. 45028/07, Judgment, 28 March 2017, para. 42.

¹⁸⁴ *Ismoilov and Others v. Russia Judgment*, para. 160, referuar GJEDNJ, *Zollmann v. the United Kingdom*, no. 62902/00, Decision, 27 November 2003; ECtHR, *Larrañaga Arando and others v. Spain*, no. 73911/16, Decision, 25 June 2019, para. 40. Shih gjithashtu GJEDNJ, *Cleve v. Germany*, no. 48144/09, Judgment, 15 January 2015, para 32-33 (“[prezumimi i pafajësisë është] një garanci procedurale në kontekstin e vetë gjyqit penal”); *Allen v. the United Kingdom Judgment*, para. 104:

[W]henever the question of the applicability of Article 6 § 2 [of the ECHR] arises in the context of subsequent proceedings, the applicant must demonstrate the existence of a link [...] between the concluded criminal proceedings and the subsequent proceedings. Such a link is likely to be present, for example, where the subsequent proceedings require examination of the outcome of the prior criminal proceedings and, in particular, where they oblige the court to analyse the criminal judgment, to engage in a review or evaluation of the evidence in the criminal file, to assess the applicant’s participation in some or all of the events leading to the criminal charge, or to comment on the subsisting indications of the applicant’s possible guilt.

Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 137.

¹⁸⁵ Shih më lart poshtëshënimin 158. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 139.

68. Gjithashtu, siç vuri re Gjykatësi i Procedurës Paraprake, misionet për zbardhjen e fakteve dhe hetimet përdoren vazhdimisht për t'iu përgjigjur situatave të shkeljeve serioze të të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁸⁶ Paneli vëren se këto raporte në disa raste u janë referuar aktorëve specifikë.¹⁸⁷ Në çdo rast, Paneli konsideron se qasja për të mos iu referuar publikisht autorëve të pretenduar në raportet e përgatitura nga misionet e KB-së për zbardhjen e fakteve lidhet me natyrën e ndryshme dhe qëllimin e këtyre raporteve. Ndërkohë që Raporti i Këshillit të Evropës ishte shtysa politike për krijimin e Dhomave të Specializuara,¹⁸⁸ këto raporte përgjithësisht synojnë mbledhjen, konsolidimin ruajtjen dhe analizimin e provave të krimeve ndërkombëtare në mënyrë që të lehtësohet dhe përshpejtohet procesi penal.¹⁸⁹

69. Në lidhje me argumentin e Thaçit se ai përballet me pengesa në përgatitjen e mbrojtjes së tij që lidhen me atë që ai e karakterizon si “fushatë shoqëruese dhe e bashkërenduar e medias”,¹⁹⁰ Paneli vëren se këto janë jashtë kontrollit të Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së. Nëse këto deklaratatë bëra nga media nuk janë një riprodhim fjalë për fjalë i informacionit zyrtar të ofruar nga autoritetet publike, nuk ka problem sipas nenit 6(2) të KEDNJ-së.¹⁹¹ Gjithashtu, Paneli vëren se GJEDNJ-ja ka

¹⁸⁶ Vendimi i Kundërshtuar, poshtëshënimi 288.

¹⁸⁷ Shih p.sh. UN Office of the High Commissioner for Human Rights, Report of the Fact-Finding Mission on Syria pursuant to Human Rights Council resolution S-16/1, August 2011, para. 32. Shih gjithashtu Apelin e Thaçit, poshtëshënimi 40.

¹⁸⁸ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 141.

¹⁸⁹ Shih p.sh. UNHRC, Report of the independent international fact-finding mission on the Bolivarian Republic of Venezuela, A/HRC/48/69, 16 September 2021, paras 13, 108-116, 118-120; UNHRC, Annual report of the United Nations High Commissioner for Human Rights and reports of the Office of the High Commissioner and the Secretary-General: Situation of human rights of Rohingya Muslims and other minorities in Myanmar, A/HRC/RES/39/2, 25 September 2018, para. 22; UNHRC, Detailed findings of the commission of inquiry on human rights in Eritrea, A/HRC/32/CRP.1, 8 June 2016, paras 332-333; UNHRC, Report of the independent international commission of inquiry on the Syrian Arab Republic, A/HRC/19/69, 22 February 2012, para. 87.

¹⁹⁰ Shih Apelin e Thaçit, para. 31. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 14.

¹⁹¹ GJEDNJ, *Mityanin and Leonov v. Russia*, nos 11436/06 and 22912/06, Judgment, 7 May 2019, para. 102.

pranuar se në një shoqëri demokratike, komente të rënda nga shtypi ndonjëherë janë të paevitueshme në çështjet që kanë të bëjnë me interesin publik.¹⁹²

70. Duke pasur parasysh sa më sipër, Paneli konstaton se Thaçi nuk ka arritur të tregojë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se përfshirja e raportit të Këshillit të Evropës në “Dokumentet Themeluese” të Dhomave të Specializuara nuk shkeli prezumimin e pafajësisë së Thaçit. Rrjedhimisht Paneli i Gjykatës së Apelit hedh poshtë pikën e tetë të Thaçit.

V. KËRKESA REFERUESE E VESELIT DREJTUAR DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË GJYKATËS KUSHTETUESE

71. Veseli kërkon si masë alternative që pika e Veselit t’i referohet DHSGJK-së.¹⁹³ ZPS-ja përgjigjet se Veseli nuk ka të drejtë për ta bërë një kërkesë të tillë duke qenë se është në “shkelje të pastër” të rregullës 75(5) të Rregullores dhe nuk ngre asnjë pikë që të vërë në dyshim kushtetutshmërinë e Ligjit.¹⁹⁴ Paneli vëren se çështja në diskutim është nëse Ligji, për sa ka të bëjë me kuadrin e të drejtës materiale të Dhomave të Specializuara, i shkakton pabarazi në kundërshtim me Kushtetutën.¹⁹⁵ Në përputhje me nenin 49(4) të Ligjit, një panel mund t’i referojë DHSGJK-së aspekte të kushtetutshmërisë së një ligji, ndër të tjera, nëse ka paqartësi në lidhje me përputhshmërinë e një ligji të kundërshtuar me Kushtetutën. Siç tregohet nga analiza më lart, kjo nuk ka ndodhur këtu. Duke pasur parasysh këtë, Paneli hedh poshtë kërkesën e Veselit për t’i referuar DHSGJK-së pikën e Veselit.

¹⁹² GJEDNJ, *Burzo v. Romania*, nos 75109/01 and 12639/02, Judgment, 30 June 2009, para. 160; GJEDNJ, *Akay v. Turkey*, no. 34501/97, Decision, 19 February 2002, para. 2.

¹⁹³ Apeli i Veselit, para 5, 51(b). Shih më lart, para. 11(e).

¹⁹⁴ Përgjigjja ndaj apelit të Veselit, para 42, 44.

¹⁹⁵ Shih Vendimin për autorizimin për apel, para 7, 66, 68(a),(d). Shih gjithashtu apelin e Veselit, para. 2.

